



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.06.2022, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”.
2. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”.
3. Miratimi i draft-rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Bankës së Shqipërisë për vitin 2021.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Benet Beci, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Dashamir Shehi, Shpresa Marnoj, Edmond Spaho, Bujar Leskaj, Ilir Topi, Blerina Gjylameti dhe Jorida Tabaku,

Mungojnë:

Enslemvera Zake, Pranvera Resulaj, Alfred Rushaj dh Agron Shehaj.

Të ftuar:

Hantin Bonati – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë
Kledia Ngjela – Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Lilika Radovicka – Drejtore e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Maksim Et'hemaj – Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil

Edlira Kraja – Drejtor Juridik i Autoritetit të Aviacionit Civil

Gentian Opre – Drejtor në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Vilma Çausholli - Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Analizës Buxhetore, Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ogerta Manastirliu – Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Mira Rakacolli - Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrera - Drejtore e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Mejvis Kola - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Saimir Kadiu - Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Flutura Beqo - Drejtor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Nejsi Lleshi - Këshilltare e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Etiola Kola - Këshilltare e Medias në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Leonora Hyka - Përgjegjëse Sektori në FSDKSH

Bora Kola - Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëdita, të nderuar kolegë deputetë!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Kuorumi i nevojshëm për fillimin e mbledhjes është i pranishëm. Në rendin e ditës të kësaj mbledhjeje kemi tri pika për të diskutuar:

shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, relator i të cilit është zoti Vullnet Sinaj;

shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, relatore e të cilit është zonja Anila Denaj;

miratimi i draft-rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Bankës së Shqipërisë për vitin 2021.

Pa humbur kohë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, shqyrtimin e projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”.

Për këtë projektligj kemi të ftuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë zotin Hantin Bonati, zëvendësministër, zonjën Kledia Ngjela, zonjën Lilika Radovicka, zotin Maksim Et’hemaj dhe zonjën Edlira Kraja, të cilëve u uroj mirë se ardhjen në komision.

Nga Ministria e Financave kemi të ftuar zotin Gentian Opre dhe zonjën Vilma Causholli.

Pa humbur kohë, po ia kaloj fjalën zëvendësministrit dhe më pas relatorit, për të vazhduar më tej me pyetjet dhe përgjigjet e tyre.

Fjala për ju, zoti Bonati.

Hantin Bonati – Përshëndetje, kryetar!

Të nderuar deputetë!

Përpara se të parashtroj qëllimin e aktit që propozojmë sot, do të doja fillimisht të bëja një parantezë të shkurtër, që mendoj se do ta ndihmojë kuptimin më të plotë të qëllimit për të cilin ne e propozojmë këtë projekt-akt.

Republika e Shqipërisë ka sovranitet të plotë në hapësirën ajrore mbi territorin e saj. Hapësira ajrore e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare, organizohet në kuadër të përdorimit të një qielli të përbashkët europian.

Qëllimi pse citova këta dy paragrafë të parë të Kodit Ajror, që besoj se do të jetë pjesë e objektit të pyetjeve dhe përgjigjeve tona më pas, është se nëpërmjet tyre del qartë se, pavarësisht sovranitetit të plotë të hapësirës sonë, në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare, ne jemi të

detyruar të unifikojmë jo vetëm aktet ligjore, por çdo komponent tjetër të funksionimit, për t'i përafuar ato me të gjithë organizmat e tjerë evropianë në fushën e aviacionit civil.

Autoritetet përgjegjëse në fushën e aviacionit civil janë ministri, Autoriteti i Aviacionit Civil, Autoriteti i Investigimit, strukturat përgjegjëse për shërbimin e kërkim-shpëtimit.

Autoriteti i Aviacionit Civil, që në vijim po e quaj vetëm "Autoriteti", është një institucion i pavarur, përgjegjës për aktivitetin e aviacionit civil kombëtar dhe ndërkombëtar në vendin tonë.

Autoriteti financohet tërësisht me të ardhurat e tij, të cilat menaxhohen dhe përdoren për të mbuluar kostot e shërbimeve të rregullta dhe të pandërprera, që ky autoritet i bën të gjithë spektrit të ofruesve të shërbimeve në aktivitetin e transportit ajror. Në këtë spektër hyjnë shoqëritë ajrore, aeroportet, Agjencia e Shërbimit të Trafikut Ajror, sikurse edhe ofrues të tjerë të këtij shërbimi.

Nga pikëpamja organizative, Autoriteti i Aviacionit Civil e ushtron përgjegjësinë e tij në mënyrë hierarkike nëpërmjet këshillit drejtues dhe ministrit përgjegjës për Transportin.

Projektligji është iniciuar me qëllim që të përshtatë me akt ligjor Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 96 të vitit 2020, si dhe saktësimin dhe përcaktimin e të tjera detyrimeve të gjuakuara si të nevojshme dhe të domosdoshme apo të sugjeruara nga institucione ndërkombëtare për përmbushjen e plotë të detyrave dhe të përgjegjësive që ky institucion ka.

Për sa i përket Kodit Ajror, në nenin 8 të tij, krahas detyrave të mëparshme, ka të detajuar që në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil" do të duhet të përcaktohen edhe procedurat dhe legjislacioni i aplikueshëm për refuzimin, pezullimin dhe revokimin e licencave, lejeve, autorizimeve dhe certifikatave; legjislacioni i aplikueshëm në rastin e ankimimit të vendimeve të Autoritetit të Aviacionit Civil, sikurse dhe llojet e tarifave për shërbimet që ky autoritet kryen, mënyrën e përlllogaritjes së tyre, mënyrën e administrimit të të ardhurave të realizuara prej tij, përcaktime, të cilat nuk ishin të evidentuara në ligjin aktual.

Duke qenë se përgjegjësia e Autoritetit të Aviacionit Civil është e një rëndësie që implikon jo vetëm shtetin tonë ndaj shteteve të tjera, por edhe organizma ndërkombëtarë të aviacionit civil, si ICAO, Bashkimi Europian, Komisioni Europian, EASA, Eurokontroll e të tjera, si dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e kryera nga këta organizma, u adaptua ligji aktual "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", duke sanksionuar detyrimet e ligjit nr. 96/2020,

sikurse dhe adresuar elemente të tjera që gjykohen të domosdoshme për përballimin e sfidave të së ardhmes së afërt që ky sektor ka, i cili po zhvillohet me ritme shumë të vrullshme, miratimi i projekt-aktit ishte i planifikuar në programin analitik të projekt-akteve të ministrisë dhe qeverisë.

Pra, përveç nevojave që unë i parashtrova pak më sipër, që vijnë si rezultat i ndryshimit të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë, disa nga ndryshimet që konsistojnë në këtë propozim tonin janë: përcaktimi i objektit të projektligjit dhe fushës së veprimtarisë së autoritetit; zgjerimi i kompetencave të këshillit drejtues në funksion të rritjes së autonomisë institucionale, organizative dhe menaxhuese; parashikimi për krijimin e një fondi rezervë, i cili do të shërbejë për të mbuluar diferencën negative mes të ardhurave dhe shpenzimeve, duke qenë një institucion i pavarur nga pikëpamja financiare (për shembull, situata që u krijua vitin e kaluar nga pandemia dhe vështirësitë financiare për të ushtruar veprimtarinë e tij, sollën si pasojë edhe këtë propozim për fondin rezervë); përcaktime lidhur me organizimin e brendshëm administrativ dhe lidhjet specifike; parashikimi për transparencën e veprimtarisë së autoritetit në përputhje me legjislacionin në fuqi për informimin publik; parashikimi për nëpunësit e autoritetit që mbajnë pozicione të lidhura me funksione specifike dhe që kanë akses në zonat me siguri të kufizuar, të cilat duhet t'i nënshtrohen kontrollit të së shkuarës; saktësimet lidhur me të ardhurat me të cilat financohet Autoriteti, ku përcaktohet që këto të realizohen nga tarifat e vendosura për veprimtarinë që kryen autoriteti dhe llogaritjet në bazë të kostos kur është i aplikueshëm; saktësimi i mënyrës së përdorimit të të ardhurave, duke parashikuar edhe kryerjen e investimeve për rritjen e kapaciteteve dhe trajnimet profesionale të stafit, ngarkuar me detyra specifike; parashikimet lidhur me ankimimit ndaj vendimeve të autoritetit; parashikimet lidhur me të drejtën që Autoriteti duhet të ketë që të bëjë përjashtime nga zbatimet e rregullave në fuqi, veçanërisht në rastet kur parashikohet nga ligji nr.96/2020 i Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë dhe rastet që kanë të bëjnë me procedurat e detajuara, që zbatohen për dhënien, refuzimin, pezullimin apo revokimin e çdo lejeje, certifikate, licence, të parashikuar në Kodin Ajror dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Nisur nga fakti i kompleksitetit dhe i veçantisë së rregullimit të këtij sektori, si dhe nga fakti që Autoriteti i Aviacionit Civil, siç e thashë edhe pak më sipër, është me vetëfinansim, duhet të krijojë gjithashtu kushtet e thithjes së një personeli me kualitet të lartë profesional edukativ, ashtu sikurse kërkohet nga standardet dhe praktikat europiane, sikurse është përcaktuar edhe në 19 anekset e Konventës së Çikagos, ku trajnimi i vazhdueshëm i personelit mbetet një

sfidë e këtij institucioni. Vetë projekt-akti është i ndërtuar mbi pesë krerë, por unë nuk po i citoj ato për sa kohë që akti është para jush.

Ky ishte një prezantim i përmbledhur i projekt-aktit që ne propozojmë për t'u miratuar te ju.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Faleminderit, zoti Bonati!

Fjalën e ka zoti Sinaj, në cilësinë e relatorit.

Vullnet Sinaj - Faleminderit, kryetar!

Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil” është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, kurse Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

Projektligji bazohet në nenet 78, 83, pika 1, të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ashtu siç e tha edhe zëvendësministri, hartimi i këtij projektligji u diktua për disa arsye, ndër të cilat mund të evidentojmë se veprimtaria e Autoritetit të Aviacionit Civil, për shkak të rëndësisë që mbart si institucion, është në vëzhgim dhe auditim të vazhdueshëm nga organizmat ndërkombëtare kompetente për auditimin dhe monitorimin e aviacionit civil, siç janë Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil, Agjencia e Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Europian dhe Eurokontroll.

Ndër rekomandimet e vazhdueshme të këtyre organizmave mbetet mundësimi i mekanizmave për përthithjen e stafëve teknike të kualifikuara dhe bërjen e tyre pjesë të qëndrueshme të strukturave të Autoritetit të Aviacionit Civil, me qëllim garantimin e sigurisë dhe standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, një arsye e rëndësishme që diktoi hartimin e këtij projektligji është nevoja imediate për të mundësuar unifikimin e Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar me autoritetet homologe ndërkombëtare për sa i përket mënyrës së organizimit dhe funksionimit.

Përmes ligjit nr. 96/2020, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë”, i cili është një ligj bazë për zbatim edhe nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Përmes këtij ligji është përcaktuar, ndër të tjera, se ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit

të Aviacionit Civil” përcakton procedurat dhe legjislacionin e aplikueshëm për refuzimin, pezullimin dhe revokimin e licencave, lejeve, autorizimeve dhe certifikatave; legjislacionin e aplikueshëm në rastin e ankimimit të vendimeve të Autoritetit të Aviacionit Civil; llojet e tarifave për shërbimet që ofron në mënyrën e llogaritjes së tyre dhe mënyrën e administrimit të të ardhurave të realizuara prej tyre. Janë pikërisht këto përcaktime që diktojnë edhe ndryshimet tashmë të pasqyruara në projektligjin objekt shqyrtimi, duke harmonizuar kështu edhe legjislacionin në këtë fushë. Pra, ky është edhe qëllimi i ligjit.

Projektligji synon të mundësojë, gjithashtu, rritjen e kompetencave të këshillit drejtues, në funksion të rritjes së autonomisë vendimmarrëse, institucionale, organizative dhe menaxhuese të Autoritetit të Aviacionit Civil në Shqipëri; qartësimin dhe riorganizimin e kompetencave të drejtorit ekzekutiv, rritjen e transparencës lidhur me veprimtarinë e Autoritetit të Aviacionit Civil, në respekt të legjislacionit në fuqi “Për të drejtën e informimit”, duke shtuar besueshmërinë e publikut ndaj këtij autoriteti; përcaktimin e llojit të të ardhurave të këtij Autoriteti dhe metodologjinë e përcaktimit të tarifave. Gjithashtu, projektligji sanksionon edhe mënyrën e përdorimit të këtyre të ardhurave.

Për herë të parë, projektligji propozon krijimin e një fondi rezervë, i cili do të shërbejë për të mbuluar shpenzimet e nevojshme që vijnë në kushte dhe rrethana të panjohura dhe me pamundësi parashikimi, si forca madhore apo pandemi. Gjithashtu, projektligji parashikon procedurat që do të zbatohen për dhënien, refuzimin, pezullimin apo revokimin e lejeve, certifikatave apo licencave të parashikuara në Kodin Ajror dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Autoriteti i Aviacionit Civil është person juridik jobuxhetor. Miratimi i këtij projektligji nuk parashikohet të ketë ndikime apo efekte në buxhetin e shtetit.

Në përfundim të gjithë sa prezantova më sipër, vlerësoj se miratimi i këtij projektligji do të mundësojë plotësimin e rekomandimeve të organizmave ndërkombëtare, do të rrisë reputacionin e Autoritetit të Aviacionit Civil dhe do të mundësojë harmonizimin me detyrimet e ligjit nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”. Për këtë arsye, u rekomandoj anëtarëve të komisionit ta miratojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Faleminderit, zoti Sinaj!

Fjalën e ka zoti Agalliu.

Arbi Agalliu - Faleminderit!

Eduard Shalsi - Keni pyetje apo diskutim?

Arbi Agalliu – Kam diskutim dhe pyetje.

Eduard Shalsi – Dakord. Nëse ndonjë deputet tjetër kërkon fjalën, të më bëjë me dije.

Arbi Agalliu – Atëherë, ka pasur shumë raste, të vërtetuara edhe në raportet ndërkombëtare apo nga çfarë kemi parë dhe dëgjuar në gjithë këto vite, që punësimi në tërësi në administratën publike përdoret për të punësuar individë, të cilët janë ose anëtarë partie, ose individë që kanë lidhje të drejtpërdrejta me pushtetarë të caktuar. Kjo ka qenë një gangrenë e administratës publike në këta 30 vjet, por e shumëfishuar në vitet e fundit. Nga ana tjetër, po të shikojmë proceset gjyqësore që punonjës të caktuar kanë fituar ndaj administratës publike ndër vite, do të kuptohet qartë si njerëzit janë larguar nga puna dhe si janë marrë individë të caktuar në punë.

Në këtë kontekst, pa dashur ta paragjykoj këtë akt, por nga e shkuara nuk më lihet të mendoj ndryshe, statusi i nëpunësit civil është një barrierë, sado që shpeshherë nuk zbatohet, për të rregulluar punësimin sidomos në këto kohë.

Është e vërtetë ajo që thoni se mund të ketë pozicione pune shumë teknike, madje përmendët faktin që Autoriteti është me vetëfinancim ndaj dhe stafi duhet i kualifikuar, por kjo nuk do të thotë që në pozicionet e tjera të administratës publike, të cilat paguhen nga buxheti i shtetit, nuk kërkohet staf i kualifikuar. Unë nuk besoj se këto pozicione të caktuara teknike janë në shumicën dërrmuese të autoritetit.

E para, sa është përqindja e stafit që ka një specifikë të caktuar teknike dhe statusi i nëpunësit civil dhe e gjithë procedura e pengon që ky të hyjë në punë me atë lloj kategorie, qoftë të pagesës, qoftë pozicionit? E dyta, ky projektligj i jep të drejtën Kryeministrit për të emëruar anëtarët e këshillit drejtues, drejtorin ekzekutiv dhe më pas vijon zinxhiri, sikurse ka ndodhur në këto vite pjesa e emërimit politik apo largimit nga puna për arsye politike. Cila është garancia që punësimi në Autoritet apo largimet nga Autoriteti nuk do të kenë fokusin politik? Pra, çfarë e mbron?

Unë besoj se anëtarët e Këshillit Drejtues do të duhet të kalojnë nga Kuvendi i Shqipëri, por kjo është çështje tjetër. Gjithsesi, Kodi i Punës mund të vlejë për këto pozicione të caktuara, qoftë kontrata shërbimi, qoftë si i jashtëm, qoftë kontrata specifike. Pra, sa përqind e stafit të autoritet kanë specifikë të caktuar që do të duhet ky lloj ndryshimi? Nga historia e këtyre viteve

është parë që administrata publike është përdorur për të punësuar individë, të cilët kanë një lloj përdorimi politik më pas.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Fjalën e ka zoti Beci dhe pastaj zonja Tabaku.

Benet Beci – Faleminderit, kryetar!

Unë kam një pyetje për nenin 6, germa “b” të projektligjit, kompetencat e këshillit drejtues, i cili thotë: “Këshilli drejtues propozon te ministri strukturën organizative të Autoritetit, e cila miratohet me urdhër të ministrit”. Nga ana tjetër, në nenin 17 thuhet se struktura dhe organika e Autoritetit miratohet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit, pas konsultimit paraprak me institucionet. A ka kjo një nonsens dhe a ka një shpjegim nga ju pse janë të dy nene?

Gjithashtu, do të doja të dija në mënyrë të shkurtuar si paraqitet sot situata financiare e autoritetit, çfarë pritet pas përmirësimeve ligjore dhe si do të ndikojnë ndryshimet që paraqesim sot mbi performancën financiare-teknike ndaj autoritetit?

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Po, zonja Tabaku.

Jorida Tabaku - Faleminderit, kryetar!

Unë kam disa shqetësime. Me sa kuptoj, detyrimi ka lindur si rezultat i përcaktimeve në Kodin e ri Ajror, që ka kaluar në vitin 2020, dëgjova edhe shpjegimin për unifikimin me autoritetet të tjera, në vende të tjera, detyrime që lindin nga marrëveshjet.

Kam disa pyetje që lidhen kryesisht me menaxhimin financiar, me pavarësinë financiare të institucionit, por njëkohësisht edhe për sa u përket procedurave të raportimit dhe të kontrollit. Ministria e Financave ka ndonjë shqetësim për sa i përket statusit që do të ketë institucioni? Do të vazhdojë të ketë të njëjtën marrëdhënie me Ministrinë e Financave për çështjet e raportimit apo do të jetë një institucion jashtë buxhetit të shtetit?

Elementi i dytë, zëvendësministri përmendi faktin që do të ketë disa specifikime dhe një fond rezervë për të ardhurat, për shpenzimet që vijnë edhe si rezultat i dinamikave të vitit të fundit, të COVID-it, ku pati edhe mungesë udhëtimesh, çfarë nënkupton kjo nga pikëpamja financiare? Do të menaxhohet fondi rezervë me të ardhurat e vetë autoritetit apo do të ketë burime financiare të angazhuara?

Së fundi, për sa u përket sekuestrimit të aseteve, kemi dëgjuar shpesh në media që çështja “Becheti” ka ndikuar në sekuestrimin e disa aseteve që lidhen me aviacionin civil, por asnjëherë nuk kemi pasur ndonjë informacion për këtë çështje. Si është e vërteta e të ardhurave të aviacionit civil, që vijnë nga tarifat të sekuestruara në lidhje me detyrime arbitrazhi ndërkombëtare që mund të ketë qeveria shqiptare?

Eduard Shalsi - Zonja Koliqi.

Emilja Koliqi – Faleminderit!

Në nenin 15 ku janë shënuar kriteret për emërimin e drejtorit ekzekutiv më duket se tejkalohe të gjitha kriteret që vendosen në të gjitha ligjet e tjera. Shprehimisht thuhet: “...të zotërojë diplomë të nivelit master i shkencave apo master profesional, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vjet akademike ose të barasvlershme me to sipas legjislacionit për arsimin e lartë”. Pse është vendosur gjithë ky sqarim, në një kohë që mund të thuhet thjesht, siç thuhet nëpër kriteret e emërimeve në ligje të tjera, në vende të tjera pune, ku thuhet, “master i shkencave ose master profesional”?

Edhe diçka tjetër, meqenëse jemi tek Autoriteti i Aviacionit Civil, duket se masteri profesional është i mjaftueshëm, ndërkohë që për shumë vende të tjera pune kërkohet master shkencor. Duket sikur është i paracaktuar personi që do të caktohet si drejtor ekzekutiv!

Në lidhje me të ardhurat e Autoritetit thuhet se ky Autoritet është institucion jobuxhetor, por thuhet edhe që të ardhurat e vitit 2021 të papërdorura nga Autoriteti do të jenë pjesë e buxhetit të Autoritetit. Pse është cilësuar kjo pikë në lidhje me të ardhurat e viti 2021? Në qoftë se ai është institucion jobuxhetor dhe ka vetëfinancim, patjetër që të ardhurat mbeten në atë njësi ekonomike dhe nuk është nevoja të përcaktohen. A ka ndonjë ndryshim në legjislacion në lidhje me rezultatin ekonomik të kësaj njësie ekonomike?

Gjithashtu, për fondin rezervë thuhet se duhet të plotësohet gradualisht dhe brenda 5 vjetësh duhet të arrijë nivelin mesatar të 6 - mujorit të dytë të buxhetit të 3 vjetëve të fundit, si dhe teprica e të ardhurave do të derdhet çdo vit në buxhetin e shtetit. Pra autoriteti është jobuxhetor me financim apo është pjesërisht buxhetor? Si është statusi i mirëfilltë i këtij institucioni?

Ju faleminderit!

Eduard Shalsi - Atëherë, sërish zonja Tabaku, për pyetje.

Jorida Tabaku - Kam vetëm diçka që e harrova kur bëra komentet e para për sa i përket auditimit dhe kontrollit të pasqyrave financave vjetore. A do të ketë ndonjë ndryshim për sa i përket raportimit të institucionit? Është krijuar ideja se për institucionet që i gjenerojnë vetë të ardhurat ka një mungesë kontrolli. Çfarë detyrimesh ka institucioni dhe çfarë implikimesh të tjera ka sjellë ligji?

Eduard Shalsi – Thjesht për sqarim: Autoriteti i Aviacionit Civil është një person juridik jobuxhetor, pra nuk financohet nga buxheti i shtetit. Në këtë kontekst, menaxhimi i financiar dhe buxhetor i këtij institucioni nuk menaxhohet nga ligji për menaxhimin buxhetor dhe fondi rezervë do të përbëhet nga të ardhurat e krijuar nga vetë institucioni, të cilat do të mbarten dhe institucioni nuk do të kërkojë një financim nga buxheti i shtetit.

Thjesht për një sqarim e thashë këtë gjë. Gjithsesi, do të flasim ekspertët.

Zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Atëherë, tek objekti i këtij ligji, tek pika “b” thuhet: |Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për procedurat dhe legjislacionin e aplikueshëm për refuzimin, pezullimin dhe revokimin e licencave, lejeve autorizimeve dhe certifikatave legjislacionin e aplikueshëm në rastin e ankimit të vendimeve të Autoritetit”. Ky është objekti i ligjit. Po të shkojmë te neni 27, që ka lidhje me objektin, ku thuhet licencat, “lejet dhe certifikatat”, thuhet: “Autoriteti ngarkohet të hartojë procedurat e detajuara, që do të zbatohen për dhënie, refuzim, pezullim apo revokim të çdo lejeje, certifikate apo licence të parashikuar në Kodin Ajror dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij”.

Mendimi im, në rast se ligji ka atë objekt, pse të mos i kishit parashikuar edhe te neni 27 rregullat e revokimit të procedurave të licencave dhe certifikatave?

Eduard Shalsi – Në rregull.

Fjala për përfaqësuesit e ministrisë apo të autoritetin? Kush do të flasë?

Do i referoheni deputetit, pyetjeve?

Hantin Bonati - Kam bërë listën me pyetje, do të kthej përgjigje dhe kolegët e mi mund të më plotësojnë në momente të caktuara.

Eduard Shalsi – Në rregull.

Hantin Bonati - Do t'i marr me radhë pyetjet sikurse u shtruan.

E para, ishte për një specifikim të caktuar me përqindje të pozicioneve që kanë një specifikë të veçantë. Është shumë e vështirë të përkufizojmë “specifikë të veçantë”, sepse vetë

institucioni, sikurse e thashë, operon në një fushë të veçantë, ku nuk ka kufij pjesa e qiellit, por është një standard dhe ka normale rregullatore për të gjitha vendet e Bashkimit Europian dhe për ato vedne që janë në perspektivë për t'u bërë pjesë e tij.

Pika e dytë e të njëjtës pyetje kishte të bënte me Kodin e Punës dhe statusin...

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Arbi Agalliu – Kur ne kërkojmë të ndryshojmë punësimin dhe të heqim statusin e nëpunësit civil, sepse institucioni paska kërkesë për individë, të cilët kanë specifika të caktuara, do të thotë që është një fenomen në masë. Pra, nuk bëhet fjalë për 1, për 2, për 3, por është fenomen në masë dhe statusi i nëpunësit civil e pengon këtë proces. Prandaj pyes: sa është ky fenomen? Nëse bëhet fjalë për 1, 2, 3 apo 5 individë mund të gjendet një mënyrë tjetër punësimi, sikundër është Kodi, për të ruajtur statusin e nëpunësit civil. Pastaj ndryshon puna nëse fenomen është në masë ky dhe do të duhet që i gjithë institucioni të mos funksionojë me statusin e nëpunësit civil.

Hantin Bonati - Është pikërisht ajo që nisa të thosha pak më parë, nuk ka të bëjë me numrin sesa ka të bëjë me objektin e veprimtarisë, që ka ky institucion për të ekzekutuar. Është objekti i veprimtarisë specifike të veçantë që kërkon ekspertizë të veçantë dhe përveç kësaj janë 3 momente kryesore për të cilat ne themi që ligji i nëpunësit civil krijon disa problematika, të cilat ne mendojmë se mund t'i adresojmë në propozimin e bërë.

E para, ka të bëjë me vetë rekomandimet që kanë ardhur nga institucionet ndërkombëtare dhe studimet që janë bërë në vitet e mëparshme. Në qoftë se ju doni informacione më të detajuara mbi këto studime, drejtori i Autoritetit mund t'ju japë, ato rekomandojnë se mënyra e funksionimit, autonomia e këtij institucioni dhe mënyra sesi duhet të përzgjidhen stafet, ka një specifikë të veçantë, që duhet të ketë një autoritet të ndryshëm nga ia nëpunësit civil.

Pika e dytë ku ne mbështesim propozimin tonë, është vetë ekspertiza dhe specifikat, se këtu flasim për pilotë, për inxhinierë aviacioni për karakteristika të ndryshme, të cilat janë shumë të vështira jo vetëm për t'i gjetur në tregun e punës, por edhe për t'i mbajtur me kategorizimin e pagave që vetë ligji i nëpunësit civil i dikton. Pra, në qoftë se ligji i nëpunësit civil flet për një pozicion inspektor, kategoria e pagave fillon unifikohet për të gjithë tipologjinë e inspektorëve, ndërkohë këtu inspektimi bëhet nga pilotë, nga inxhinierë aviacioni dhe kështu me radhë, dhe kjo dikton që të ketë një ndryshim nga norma e përgjithshme për të cilën ligji i nëpunësit civil rregullon.

E treta, ka të bëjë edhe me specifikat dhe pamundësitë për t'i marrë këta persona, për t'i tërhequr pranë këtij institucioni dhe për t'i mbajtur të motivuar. Kjo pamundësi dikton, se në periudha të ndryshme sikurse edhe tani, në mos gaboj, nga 80 vende që ka institucioni 17 prej tyre janë vakante, që një ekspertizë ta marrësh nga palë të treta. Pra, institucioni detyrohet të paguajë ekspertizë nga jashtë tij, dhe përveç kostos që është shumë më e lartë, krahasuar me koston për punonjës në brenda institucionit, ekspertiza të vonon në kohë dhe në dinamikë. Kjo për sa i përket propozimit tonë për të dalë nga statusi i nëpunësit.

Për pyetjen se cila është garancia, garancia është vetë qëllimi, që këta punonjës t'i kemi sa më të motivuar dhe vetë kuadri ligjor rregullon garancinë që një institucion publik ka, që t'i mbrojtë edhe interesat e punonjësve.

Për sa i përket pyetjes së zotit Beci, lidhur me nenin 17, e kemi diskutuar edhe në komisionet e tjera, është reflektuar edhe nga Komisioni i Ligjeve që ka një mospërputhje, është edhe në vëmendjen tonë kjo çështje.

Në lidhje me pyetjen e deputetes Tabaku për veprimtarinë, ky është një institucion që nuk merr fonde nga buxheti i shtetit. Mënyra sesi këto fonde grumbullohen nga autoriteti janë të përcaktuara edhe në kuadrin ligjor.

Po ashtu, edhe fondi rezervë është parashikuar, sepse rasti i fundit i pandemisë, që solli mungesa të fluturimeve ajrore, që janë një pjesë e mirë e fondeve mbi të cilat ndërtohet buxheti i Autoritetit të Aviacionit Civil, solli edhe vështirësi financiare për këtë institucion. Këto fonde që nuk merren vetë nga buxheti i shtetit, do të krijojnë këtë rezervë, për të cilën gjukojmë se është e domosdoshme. Metodologjia e krijimit të rezervës është e përcaktuar në ligj, ku në 5 vjetët e fundit do të merret mesatarisht realizmi i tre 6 mujorëve të fundit për të krijuar fondin rezervë. Kjo do t'i japë një frymëmarrje institucionit dhe me krijimin e kësaj rezerve përsëri fondet do të vazhdojnë të derdhen në buxhetin e shtetit, sikurse ka qenë më përpara.

Për sa i përket sekuestrimit të aseteve, në dijeninë time nuk ka sekuestrim asetesh, ka një problematikë e cila po ndiqet në rrugë gjyqësore, por sekuestrim asetesh në dijeninë time...

(Deputetja Jorida Tabaku ndërhyr pa mikrofon.)

Në dijeninë time nuk ka as asetë, as llogari bankare të sekuestruara.

Jorida Tabaku - Janë të pavërteta të gjitha njoftimet që asnjë e ardhur e Autoritetit nuk është prekur, këtë po konfirmoni?

Hantin Bonati - Në dijeninë time nuk ka asnjë aset të sekuestruar. Ka disa problematika financiare që janë disa të ardhura të bllokuara dhe është një proces gjyqësor që po vazhdon.

(Deputetja Jorida Tabaku ndërhyr pa mikrofon.)

Nuk e kam këtë informacion. Domethënë, pjesa e të ardhurave është nga AlbKontrolli që është një shoqëri aksionere, ndërsa ne po flasim për Autoritetin e Aviacionit Civil. Nuk jam i përgatitur për këtë përgjigje për sa kohë që jemi duke folur për një institucion tjetër.

Për sa i përket pyetjes për kriteret që duhet të ketë drejtori ekzekutiv.

(Diskutim pa mikrofon)

Për raportimet dhe kontrollin, ky ligj nuk sjell ndryshime.

Edlira Karaj - Autoriteti i Aviacionit Civil është institucion që i nënshtrohet komplet ligjit të menaxhimit financiar për pjesën e raportimit dhe të kontrollit. Domethënë, të gjitha pasqyrat financiare të Autoritetit auditohen nga ekspertët kontabël të certifikuar dhe dorëzohen me bilancet respektive.

Hantin Bonati - Për të vijuar me përgjigjet për pyetjet e tjera, për fondin rezervë të vitit 2021, besoj se përgjigjja e mëparshme e përmbledh edhe këtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla.)

Do e japë drejtori ekzekutiv këtë përgjigje.

Maksim Et'hemaj – Përshëndetje!

Ju falënderoj shumë për pyetjet!

Në lidhje me fondin rezervë, pra, pse duhet fondi rezervë, viti 2021 vjen pas vitit 2020 dhe sikurse ju e dini aviacioni civil është industri që është goditur më fort nga COVID-i. Vitet 2019, 2020 dhe 2021 krijuan impakte, që në nivel europian parashikohen të mbulohen deri në vitin 2025 – 2026. Kjo do të thotë që, nëse ne do të fillojmë të akumulojmë këto para dhe krijojmë fondin rezervë ose përdorimin e fondeve të vitit 2021, është vazhdimi i vitit 2020, por ende industria e aviacionit është duke vuajtur. Prandaj është e mirëpërcaktuar në ligj. Nuk e di nëse iu përgjigja pyetjes?

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla.)

Jo, ligji thotë që nëse Autoriteti i Aviacionit Civil nuk i përdor, ato do të kthehen në buxhet. Ajo që po kërkojmë ne, është që duam të blejmë kohë, për shkak se vijmë nga një situatë post-COVID-i, për afatin në fjalë 2020 -2021 kërkohet më shumë mundësi për t'i futur këto të ardhura në përdorim të aviacionit civil. Pastaj do të vazhdojë rutina për vitin pasardhës, por

prandaj kemi bërë specifikim vetëm për vitin 2021. Ne mendojmë që kjo është për t'i thënë çdo njeriu se këto janë vite të lidhura me pandeminë.

Emilja Koliqi - Pra, ju sipas ligjit që është sot në fuqi, të ardhurat që ju kanë tepruar duhet t'i derdhnit në buxhet, por meqenëse ju nuk po i derdhni, nuk doni ta zbatoni ligjin ekzistues e keni vendosur këtë gjë këtu, për të krijuar fondin rezervë? Kjo është arsyeja?

Maksim Et'hemaj – Jo s'e nuk donim t'i shpenzonim, por nuk mundeshim fizikisht t'i shpenzonim, sepse në periudhën 2020-2021 të gjitha institucionet e trajnimit, të pjesëve rezervë, të mirëmbajtës ishin të mbyllura, njerëzit ishin në shtëpi. Kjo është arsyeja. Unë besoj se ju e kuptoni shumë mirë faktin që ne ishim në kohë COVID-i.

(Diskutime pa mikrofon)

Maksim Ethemaj – Ne po themi që në kushte normale tepricat, për shkak të pamundësisë së investimit, duhet të shkojnë në buxhet. Ndërkohë, unë po them të na e lini edhe vitin 2021 të mos shkojë në buxhet. Ky është një përjashtim.

Në qoftë se nuk është e kuptueshme, ta gjejmë një fjalë tjetër, por ky është konteksti.

(Deputetja Koliqi flet pa mikrofon.)

Edlira Kraja – Nëse më lejoni, i gjithë shqetësimi që ju shtruat për sa i përket pjesës së detajuar të kriterit të zotërimit të nivelit “Master” është amenduar te Komisioni i Ligjeve, duke bërë një parashikim të përgjithshëm lidhur me formimin e përgjithshëm të drejtorit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Drejtori ka diçka për të shtuar.

Maksim Et'hemaj – Meqenëse drejtori në fjalë jam unë në këtë rast, unë quhem Maksim Ethemaj, kam 30 vjet eksperiencë në aviacionin civil, vij nga Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror, nga Albcontrol-i, dhe kam punuar në projektet më të mëdha të zhvillimit të aviacionit civil në Shqipëri.

Kështu që, si drejtor, nuk do të kisha nevojë fare, pasi çdo lloj kërkese që do të vendosej në atë ligj do ta plotësoja dhe do të punoja me kënaqësi për ta zhvilluar aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë.

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Atëherë, dy komente të shpejta. Pastaj, nëse ka pyetje të tjera, t'i bëjmë para se të kalojmë në votim.

Arbi Agalliu – Jam plotësisht dakord që në këtë situatë mund të ketë nevoja shtesë emergjente për të përballuar situatën dhe, me të drejtën tuaj, mund të thoshim që çfarë akumulohet, të ngelet tek Autoriteti për të përballuar situatën. E kuptova qartë?

Hantin Bonati – Deri në normën e rezervës.

(Diskutime pa mikrofon)

Arbi Agalliu – Deri në normën e rezervës? Shumë dakord. Po pas një viti, kur nuk do të jemi më në kushte pandemie të tilla, ligji do të jetë i njëjtë, nuk do të ketë ndryshuar. Do të vini me një ligj tjetër apo...?

Eduard Shalsi – Pse?

Arbi Agalliu – Sepse po thoni që tepricat do të ngelen...

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, kjo rezervë do të qëndrojë gjatë gjithë kohës në një sasi të caktuar, që përcaktohet dhe, mbi këtë rezervë, vitet pasardhëse do t'i shkojnë buxhetit të shtetit?

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull, është e qartë.

Eduard Shalsi – Fjalën e ka zonja Tabaku dhe pastaj zoti Shehi.

Jorida Tabaku – Për shqetësimin që unë pata, nuk e dëgjova Gentin, në fakt, nga pikëpamja e statusit të institucionit.

Ne kemi pasur një debat shumë të gjatë para vitit 2013 në lidhje me statusin dhe raportimet, me faktin që institucioni ka, sigurisht, një karakteristikë ndryshe nga të gjitha institucionet e tjera dhe nuk mund të presupozojmë edhe për sa i përket punësimit, pra lidhur me ligjin e nëpunësit civil, e shërbimit civil. Por nga pikëpamja financiare unë kam dëshirë të dëgjoj mendimin e Ministrisë së Financave, pasi ato janë disa çështje, të cilat, në gjykimin tim, janë ose të paqarta, ose të paspecifikuara mirë.

Lilika thotë se është subjekt i ligjit për menaxhimin e shpenzimeve, për raportimin dhe kontrollin, ndërkohë që nuk është subjekt i ligjit “Për menaxhimin e shpenzimeve publike”, sepse ka një situatë tjetër financiare.

Mendoj se kemi nevojë për më shumë qartësim nga pikëpamja e raportimit dhe kontrollit të pasqyrave financiare dhe njëkohësisht të parashikimit të shpenzimeve, sepse ne këtu po diskutojmë për një fond tani rezervë, që unë ende e kam të paqartë nëse ligji do të ketë efekt prapaveprues (sepse fondi u krijua si rezultat i situatës së Covid-it), por situata e Covid-it nuk

është më tani, apo do të jetë në vijimësi për të ardhmen dhe e marrim të mirëqenë atë çfarë ndodhi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Do të marrim edhe pyetjen e zotit Shehi, apo...

Gentian Opre – Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Jepeni përgjigjen, atëherë.

Gentian Opre – Thjesht për të rikonfirmuar atë që tha zonja Radovicka, që institucioni është jobuxhetor dhe u nënshtrohet të gjitha rregullave të menaxhimit financiar të kontrollit, kështu që është subjekt auditimi edhe nga KLSH-ja, përveç audituesit ligjor, që është i shprehur dhe i sanksionuar në këtë ligj.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Po, zoti Shehi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dashamir Shehi – Tani, unë gjykoj se te kjo ndërmarrja juaj, kjo pjesa financiare, sado e rëndësishme për momentin, është e dorës së dytë, gjykimi im ky. Përse? Ju jeni një aparat teknokratësh që duhet të jepni disa garanci të tjera, prandaj është bërë edhe ky përjashtimi për nëpunësit tuaj, sepse nuk mund të jenë thjesht nëpunës të shërbimit civil, siç ka tek të tjerat, së pari, sepse kërkohen disa lloje kompetencash dhe, së dyti, kërkohen disa lloje pagesash të veçanta.

Tani, unë dua të sqaroj se shumica prej nesh këtu po flasim, por jemi pak të paqartë. Cili e mbulon të gjithë hapësirën e çështjeve të aviacionit? A ka mbivendosje ky ligji juaj? A i sqaron të gjitha ato? Se këtu janë shumë institucione tani. Ju keni drejtorinë atje në ministri, që mbulon Aviacionin Civil, u bë ky enti i Autoritetit të Aviacionit Civil, kemi edhe Albkontrollin. A janë sqaruar të gjitha kompetencat tani: cila mbivendoset, cila vendoset, ku mbaron kufiri i politikave? Se edhe këtu e keni të shkruar “Drejtoria e Politikave”. Cili i ka të drejtat e licencave, të kontrolleve mbi aviacionin, mbi fluturimet, mbi këto? Se unë gjykoj që kjo është puna më e rëndësishme që kemi këtu, sesa këto çështjet tuaja financiare, madje edhe çështjet organizative tuaja. Duket sikur ligji po bëhet që të zgjidhim këto hallet e lekëve dhe se si do t’i vendosim drejtorët e shefat, ndërsa unë po them që do të zgjedhim një gjë pak më të madhe në këtu, ore, se kush i ka kompetencat mbi ajrin shqiptar? Cili do t’i mbajë përgjegjësitë për këto punë? Si do të

gjejmë një formulë të re rekrutimi që të marrim ato që duhen, jo ato që na sjell partia? Prandaj janë bërë gjithë këto xhepa: nuk ka nevojë për shërbim civil, nuk ka nevojë për këtë, pagesa nuk ka tavan, se për këtë punë janë bërë.

Po na i shpjegove këto me dy-tri fjalë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Maksim Et'hemaj – Faleminderit, zoti Shehi, për pyetjen!

Më lejoni t'ju shpjegoj sa më shkurt dhe sa më preکشëm cili është roli i Autoritetit të Aviacionit Civil.

Autoriteti i Aviacionit Civil ka për detyrë, së pari, të licencojë në momentin e parë kur operatorët ajrorë ose siguresit e shërbimit hyjnë në biznes, bëjnë biznes.

Së dyti, detyra tjetër e Autoritetit të Aviacionit Civil është të bëjë mbikëqyrjen e këtyre operatorëve dhe të Albcontrol-it përkundrejt standardeve.

Së treti, të detyrojë operatorët ajrorë dhe, sigurisht, ata të shërbimit të trafikut ajror për masa të menjëhershme rregullative nëse konstatohet se ka elemente që cenojnë sigurinë në operim.

Së katërti, të trajnojë dhe të ndajë informacione me të gjithë familjen e industrisë së Aviacionit Civil në Republikën e Shqipërisë.

Së pesti, të nxjerrë kompanitë, operatorët ajrorë dhe siguresit e shërbimit të trafikut ajror, nëse dështojnë të plotësojnë kërkesat rregullative të kërkuara nga legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar.

Këto janë pesë funksionet kryesore të Aviacionit Civil.

(Deputeti Shehi flet pa mikrofon.)

Eduard Shalsi – Ndizeni mikrofonin.

Maksim Et'hemaj – Një shembull i vetëm që po më vjen ndër mend, po të lexoni draftligjin, pra nëse shikoni ligjin paraprak, nuk flitet se çfarë janë inspektorët. Inspektorët janë persona fizikë të certifikuar, të licencuar dhe të trajnuar që përfaqësojnë Autoritetin e Aviacionit Civil në aktivitetet audituese. Në ligjin paraardhës ky nuk ishte dhe është një diferencë në koncept.

Pra, në qoftë se ju merrni ligjin aktual, nuk i gjeni funksionet e mbikëqyrjes. Ndërkohë, ky ligj përcakton qartësisht personin të cilit i jepen këtotribute.

Ky ishte një rast.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – A ka ndonjë koleg tjetër për të shtuar diçka? Nuk ka.

Tani, në mos gaboj, në statusin e nëpunësit civil u fut në vitin 2014 apo jo, Entelë? Në vitin 2013 apo në vitin 2014?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, i vendosëm në statusin e nëpunësit civil para disa vitesh, ndërsa sot po i heqim.

Jam shumë kurioz të dëgjoj debatin e atëhershëm për të argumentuar se si janë bërë pjesë e statusit të nëpunësit civil. Gjithsesi, merak i madh që ekziston është se vërtet po dalim jashtë statusit të nëpunësit civil, por ka disa eksperiencë të mahnitshme në autoritetet e aviacioneve civile në lidhje me rekrutimet dhe për këtë jemi të gjithë të vetëdijshëm, në fakt.

I gjithë merak ynë është të dominojë profesionalizmi dhe të mos përsëriten ato gjëra që në të kaluarën i kanë shëmtuar aq shumë ato institucione sa që ende vazhdojnë të jenë objekt barcaletash apo anekdotash.

Drejtor, ju thatë se keni 30 vjet në profesion, ju njohim, por përgjegjësia është të sigurojmë dhe të garantojmë edhe ne si ligjvënës për zbatimin e ligjit që në sektorë të tillë, vërtet po i heqim nga statusi i nëpunësit civil, por t'u vihet një barrierë e fortë, e madhe, edhe atyre lloj emërimeve që në të kaluarën nuk është se kanë qenë një fenomen i zakonshëm. Pra, ky është merak ynë. Dakord? Ndaj duam të sigurohemi se do të jenë profesionistët ata që do ta menaxhojnë dhe nuk do të ketë vend për qoka, po themi, quajini politike apo quajini familjare, apo quajini nepotike, si të doni ju.

Mirë, nëse nuk ka ndonjë koleg tjetër që dëshiron të shtojë diçka...

Edhe një merak nga zonja Tabaku.

Jorida Tabaku – Unë kam vetëm një merak për fondin rezervë: përdorimi i fondit rezervë do të jetë vetëm me vendim bordi? Çfarë do të ndodhë në situata të tjera të ngjashme? Nuk vendosim dot ndonjë mekanizëm kontrolli në këtë rast?

Është e vërtetë që Autoriteti është i pavarur, por mund ta lidhim me disa faktorë. Vetëm këtë shqetësim kam nga pikëpamja e rrugës që mund t'u hapim abuzimeve në qoftë se, në gjykimin tim, mund të bëhet fjalë për fonde të konsiderueshme në situata të tjera, se, sigurisht, kjo që iku, iku. Puna është se ligji po bëhet nga pikëpamja afatmesme dhe afatgjatë, duke pasur parasysh se çfarë do të ndodhë në të ardhmen, se nuk bëhet vetëm për një situatë të caktuar.

Hantin Bonati – Mendoj se kur parashtrohet, shqetësimi është për t'u pasur në vëmendje, por që përcaktimet të jenë të qarta, se kur do të jetë momenti që të përdoret ky fond, në gjykimin tim, do të jetë e vështirë, sepse paparashikueshmëria është e tillë që...

(Deputetja Tabaku flet pa mikrofon.)

Mekanizmi? Tani, ky është një institucion që ka fonde në dispozicion, që i menaxhon të gjitha fondet...

Pse fondet e buxhetit vjetor nuk kanë një mekanizëm tjetër? Pra, është po i njëjti institucion që do të menaxhojë fondet e buxhetit vjetor, ashtu sikurse ato të paparashikueshmërisë. Prandaj ia kemi besuar titullarit të institucionit dhe këshillit drejtues menaxhimin e fondeve. Në këtë rast ky besim vlen edhe për fondet rezervë që të përdoren në mënyrën më eficiente.

Eduard Shalsi – Atëherë, nëse nuk ka diçka tjetër për të shtuar...

Po, zoti Spaho.

Edmond Spaho – Po në këtë linjë, do të desha të sqarohem.

Tani, ju jeni një institucion që administroni një pasuri publike. Domethënë, *fee*-të që merrni, në fakt, janë pasuri e të gjithë shtetit, nuk janë tuajat si institucion, por ju keni aftësitë profesionale që t'i trajtoni dhe të krijoni edhe kushte për të rritur të ardhurat.

Sigurisht, për të qenë profesionalë dhe konkurrues në një nivel me vendet e tjera, sepse duhet të plotësohen të njëjtat rregulla, ju keni nevojë të bëni investime e të tjera e të tjera, të paguani stafin shumë më mirë sesa...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...por në hartimin e nevojave tuaja, kush ju kontrollon? Ka ndonjë mekanizëm që ju kontrollon apo...? Jo, është tjetër punë kur hartoni buxhetin dhe pastaj vjen kontrollon kontrolli për buxhetin. Kur e bëni buxhetin, kush ju kontrollon? Që të jemi të ndershëm dhe të dimë se atje nuk abuzohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por në përputhje me politikat që ka vendosur shteti në këtë sektor, këto para përdoren për destinacionin dhe, nëse ka para më tepër sesa nevojat, ato derdhen në buxhetin e shtetit. Domethënë, përshtypja ime është që kujtdo, po i le para pa kufizim, do ta gjejë mënyrën se si t'i shpenzojë ose të hartojë një buxhet të tillë që...

Mendoj se edhe shqetësimi i kolegëve këtu ishte: si evitohet abuzimi?

Eduard Shalsi – Faleminderit!

(Deputeti Spaho flet pa mikrofon.)

Maksim Et'hemaj – Faleminderit, zoti Spaho, për pyetjen!

Do të doja t'ju shpjegoja pak a shumë se si ne kontrollohemi.

Unë besoj se Aviacioni Civil është nga entet e pakta në Shqipëri që monitorohet si nga brenda, ashtu edhe nga jashtë.

Zoti Agalliu tha se, referuar raportit të të huajve, ka mungesë stafi e të tjera, pra abuzime në largimet e stafit, ndërsa unë po ju them që, referuar raporteve ndërkombëtare të periudhës janar 2022...

Jo, nuk ka gjë, por dua ta lidh...

Duke iu referuar raporteve ndërkombëtare, në janar të vitit 2022, të bëra nga Organizata Botërore e Aviacionit Civil, dhe raporteve në maj të vitit 2022, të bërë nga Komisioni European (këto janë dy autoritete që na monitorojnë), del qartësisht nevoja urgjente për ndryshim, por nuk po i hyj se çfarë ndryshimi, te paratë, te këto... Ka nevojë për ndryshim, e para, dhe këtë dua ta lidh tani me shqetësimin e drejtë të zotit Spaho.

Autoriteti i Aviacionit Civil mund të harxhojë buxhete, por në qoftë se këto buxhete nuk kontifikohen, nuk materializohen në rritjen e cilësisë së standardeve në arenën ndërkombëtare, atëherë, po, është një problem.

Pra, për mua mekanizmi i kontrollit është shumë i thjeshtë: paratë që harxhon, a e kanë ngritur më lart Aviacionin Civil përkundrejt standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare? Në qoftë se përgjigjja është po, ky është qëllimi i aviacionit, që paratë e aviacionit të shkojnë në aviacion që ta çojmë më përpara.

Nuk e di, zoti Spaho, nëse iu përgjigjja pyetjes.

(Deputeti Spaho flet pa mikrofon.)

(Deputeti Shehi flet pa mikrofon.)

A mund t'ju them...?

Eduard Shalsi – Atëherë, kalojmë në votim tani?

(Diskutime në sallë)

Atëherë, se nuk u mbyllka ky debat, drejtor, kam një pyetje.

Ju keni 30 vjet në profesion. Pyetja ime është pikërisht kjo: a ndiheni i sigurt që ndërhyrjet pas heqjes së statusit të nëpunësit civil jo vetëm nuk do të ekzistojnë, por do të mund

t'i shmangni duke përdorur vetëm kriterin profesional. Të paktën me disa institucione të tjera që ky komision monitoron, përveç raportit 1 vjetor, ku ne shohim të rekrutuarit e rinj dhe ato të të larguarit, ku dukshëm kuptohet mbi ç'bazë janë larguar disa dhe mbi ç'bazë janë rekrutuar disa, gjë që na lejon ne që ndryshe nga fjalët që ne thoshim dhe ishim të shqetësuar vazhdimisht për vite të tëra në parlament nuk kishte një dokument që të na jepte të kuptonim se çfarë ka ndodhur në vitin 2010, në vitin 2013, në vitin 2015, sepse është aty evidenca se cili është futur në punë dhe cili është larguar nga puna dhe largonin muhabetet e kafeneve dhe shqetësimeve. Këtij shqetësimi në komision, të paktën me institucionet që ne monitorojmë dhe mbikëqyrim, u kemi dhënë një përgjigje dhe nuk themi pas 3 muajsh, 6 muajsh apo një viti apo dy vjetësh që ne nuk dinim se çfarë po ndodhte gjatë kohës që ne ishim komision që mbikëqyrim veprimtarinë e tyre. Ndaj, në këtë kontekst, meqenëse mendojmë se kushtet janë pjekur për ta mbajtur dhe për t'i mbajtur disa institucione larg ndërhyrjeve të tilla, pyetja është: a jeni i sigurt që me këtë ligj dhe me këto ndryshime stafi do të rekrutohet, promovohet mbi kriteret e pastra profesionale? Për ne është garanci një person që ka 30 vjet në një fushë të caktuar. Për ju, me këto ndryshime dhe me ligjin, a ndjeheni i sigurt për të vijuar rekrutimet mbi bazë profesionale dhe administrimin mbi bazë profesionale?

Maksim Et'hemaj - Faleminderit, zoti kryetar!

Po, ndjehem i sigurt. Nuk kam qejf të jap këtë përgjigje, por, nëse e shikoni edhe sot, ku unë kam vetëm 6 muaj në pozicion, ka një ndryshim në mënyrën sesi do të afrohen. Për ne njerëzit janë të gjithë të mirë, por ka munguar një plan rritës për çdo njeri. Sot, në Autoritetin e Aviacionit Civil ne kemi ndërtuar një plan trajnimi, ku edhe stafet aktuale, edhe stafet e reja do të dinë që ditën e parë se çfarë do të ndodhi me ta dhe është një dokument që është transparent dhe do të publikohet në faqe.

Së dyti, kur kam marrë detyrën në Albkontroll kam punuar një pjesë të mirë të jetës time në pozicione menaxheriale, së fundi kam qenë në divizionin teknik, dhe në vitin 2014 kam gjetur një organizatë që importonte training, ndërsa sot unë kam një organizatë, që për shkak të COVID-it ka humbur rreth 22% të stafit inxhinierë, të cilët janë punësuar në kompanitë më të mira europiane. Pse ndodhi kjo?! Sepse ne formuam njerëz kompetentë. Nëse unë e kam bërë këtë gjë një herë, e bëj edhe 2 herë, 3 herë ose 4 herë. Faleminderit!

Eduard Shalsi - Faleminderit!

Kalojmë në votim në parim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Nga neni 7 deri te neni 14 ndiqet e njëjta procedurë)

Neni 15. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17 është ajo që keni sugjeruar për komisionin përgjegjës.

Ndërhyrje pa mikrofon

I nënshtrohet kontrollit të së kaluarës.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vullnet Sinaj - “Nëpunësit e autoritetit që mbajnë pozicione të lidhura me funksione specifike dhe që kanë akses në zona me siguri të kufizuara i nënshtrohen kontrollit, figurës dhe pajisen me certifikatë sigurie sipas legjisllacionit në fuqi”. Kështu ishte?

Maksim Et’hemaj – Po kështu u la te Komisioni i Sigurisë, por për ne kishte një moskuptim të situatës në lidhje me sigurinë. Ne kemi dy lloj stafesh në autoritetin e aviacionit civil, një staf që është përgjegjës për elementet e sigurisë së Aviacionet, i cili duhet të jetë pjesë e *background check* dhe e DSIK-së, është një pjesë tjetër stafi që nuk ka akses të drejtpërdrejtë në

dokumentet e klasifikuara, por pjesë e aktivitetit të punës së tyre është zona brenda rrethimit ë aeroportit, ku është vendqëndrimi i avionëve, të cilët bëjnë vetëm *background check*, pra nuk ka nevojë që i gjithë stafi të pajiset me DSIK-në.

Në Komisionin e Ligjeve ramë dakord që kur të jemi në komisionin që ka pronësisë e projektit, do ta modifikojmë.

Eduard Shalsi - Neni 17. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 19. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 20. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 21. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Nga neni 22 deri te neni 30 ndiqet e njëjta procedurë)

Kush është dakord në votimin në tërësi? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ju urojmë punë të mbarë!

Sekretare e Komisionit
Enslemvera Zake

Përgjegjësjja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar administrativ
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.06.2022, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i draftrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Bankës së Shqipërisë për vitin 2021”.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Benet Beci, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Dashamir Shehi, Shpresa Marnoj, Edmond Spaho, Bujar Leskaj, Ilir Topi, Blerina Gjylameti dhe Jorida Tabaku.

Mungojnë:

Enslemvera Zake, Pranvera Resulaj, Alfred Rushaj dhe Agron Shehi.

Eduard Shalsi- Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”.

Kemi një propozim: në vend të pikës së tretë të kalojmë si pikë dytë të rendit të ditës miratimin e draftrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të BSH për vitin 2021”. A ka ndonjë koment për rezolutën? Jo, nuk ka.

Ka një pikë të fundit të rezolutës që do të doja të ishte në vëmendjen tuaj, të cilën e kemi përshtatur dhe ka të bëjë fintech-un, pra, me teknologjinë e informacionit në financë dhe me radhët e gjata nëpër banka. Nisur nga shërbimet bankare, kemi dashur të inkurajojmë që Banka e Shqipërisë të nxisë bankat e nivelit të dytë që të aplikojnë sa më shumë teknologjinë e informacionit për të bërë të mundur transaksionet jofizike pranë bankave.

Nëse nuk ka ndonjë koment lidhur me rezolutën e Bankës së Shqipërisë, atëherë, e kalojmë në seancë parlamentare. Ditën e enjte është edhe raportimi i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë. Vijoj të them që me këto institucione kemi vendosur një raport jo për t’i parë një herë në vit, por çdo muaj me çështje të ndryshme.

Miratohet rezoluta e Bankës së Shqipërisë.

Dy minuta pushim dhe të marrim vesh nëse vjen ministrja ose zëvendësministrja, meqenëse ministrja është paralel në të dy komisionet e tjera.

Sekretare e Komisionit
Ensemvera Zake

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar administrativ
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.06.2022, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Benet Beci, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Dashamir Shehi, Shpresa Marnoj, Edmond Spaho, Bujar Leskaj, Ilir Topi, Blerina Gjylameti dhe Jorida Tabaku.

Mungojnë:

Enslemvera Zake, Pranvera Resulaj, Alfred Rushaj dhe Agron Shehi.

Të ftuar:

Ogerta Manastirliu – Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Mira Rakacolli - Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrera - Drejtore e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Mejvis Kola – Drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Saimir Kadiu - Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Flutra Beqo – Drejtoreshë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Nejsi Lleshi - Këshilltare e ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Etiola Kola - Këshilltare e Medias

Leonora Hyka - Përgjegjës sektori në FSDKSH

Bora Kola - Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Gentian Opre – Drejtor në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Vilma Causholli – Përgjegjëse sektori, Sektori i Analizës Buxhetore, Drejtorja e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Eduard Shalsi - Kthehemi sërish, të nderuar kolegë deputetë, tashmë me një ligj të shumëpritur. Është një lajm jashtëzakonisht i mirë ardhja në parlamentin e Shqipërisë të ligjit “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, për të cilin dua ta falënderoj personalisht ministren dhe ekipin e saj!

Të ftuar kemi zonjën Ogerta Manastirliu, ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonjën Antoneta Njehrrera, zonjën Mejvis Kola, zotin Saimir Kadiu, zonjën Flutra Beqo, zonjën Nejsi Lleshi, zonjën Etiola Kola, zonjën Leonora Hyka dhe zonjën Bora Kola. Ju uroj mirëseardhjen në komision!

Të ftuar nga Ministria e Financave kemi zotin Gentian Opre.

Pa humbur kohë, dua t’ia kaloj fjalën zonjës ministre për një shpjegim konciz.

Ligjin e kemi lexuar me shumë vëmendje dhe dëshirë. Relatore kemi zonjën Denaj. Pastaj do të kalojmë te pyetjet, komentet apo sugjerimet.

Fjala për ju, zonja Ministre.

Ogerta Manastirliu - Shumë faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministria e Shëndetësisë dhe e mbrojtjes Sociale vjen para jush për të sjellë për shqyrtim dhe miratim projektligjin “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”. të them të vërtetën, koha për të punuar këtë projektligj ka qenë një kohë relativisht konsistente, pasi kemi kaluar n dy vjet pandemi gjithmonë me qëllimin për të vijuar reformën në shëndetësi dhe punët e mira të bëra në këtë sektor, por pa dashur të linim pas, edhe pse në një kohë pandemie, edhe hartimin e legjislacionit përkatës për të mbështetur reformën e transformimit të shëndetësisë, e cila nuk mund të shihet asnjëherë e fragmentizuar, por që duhet të jetë gjithmonë e integruar në të gjitha nivelet e shërbimit, në atë parësor dhe në atë spitalor. Për këtë arsye ne kemi punuar me konsulencën e Bankës Botërore për të ndërtuar dhe për të hartuar një ligj të ri për shërbimin spitalor, i cili të reflektonte parimet bazë të solidaritetit, universalitetit, mosdiskriminimit dhe të garancisë për një shërbim spitalor cilësor, të aksesueshëm dhe të përballueshëm për të gjithë qytetarët.

Sigurisht, kur kemi hartuar këtë ligj, kemi pasur në fokus pacientin dhe shërbimin ndaj pacientit, pra qytetari ka qenë në qendër dhe në fokus të gjitha parimeve që na kanë shoqëruar në këtë ligj, por, gjithashtu, kemi pasur në fokus miradministrimin e burimeve tona, qofshin ato

njerëzore dhe ato financiare, në funksion të dhënies së një shërbimi më të shpejtë, më të aksesueshëm dhe më cilësor për qytetarët.

Kur kemi hartuar këtë ligj padyshim që kemi kaluar të gjithë fazat e konsultimit, në konsultimet e bëra me grupet e shoqërisë civile, shoqatave të pacientit apo edhe të strukturave publike, kemi marrë në konsideratë një pjesë të sugjerimeve të tyre, për të reflektuar, patjetër, një ligj, i cili jo vetëm ndërton instrumente, por, mbi të gjitha, mbështetet në parime të qëndrueshme dhe, mbi të gjitha, reflekton një vizion, që ne duam që të arrijmë për sa i përket edhe mbështetjes në qëllimet strategjike të Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2020-2030 dhe, sigurisht, të përmbushë të gjitha ato aspekte të natyrës zhvillimore në vendin tonë, që i përket kushteve demografike, të zhvillimit urban, të sëmundshmërisë, të aspekteve epidemiologjike, të cilat të adresonin me së miri në këtë ligj nëpërmjet instrumenteve përkatës.

Në ligj propozohen dhe përcaktohen qartë shërbimet spitalore, tipet e spitaleve me funksionet që ata kryejnë dhe me vizionin për të pasur spitale, të cilat të mundën të organizojnë punën në mënyrë më eficiente, duke nisur nga baza e spitalit: spital ditor, spitale bashkiake, spital në nivel qarku, spitalet në nivel rajoni dhe ato terciare dhe universitare. Kemi përcaktuar qartë mënyrën e funksionimit dhe të ndërveprimit mes tyre, për të siguruar në mënyrë të integruar kujdes shëndetësor e cilësor, të aksesueshëm dhe të përbalueshëm për çdo qytetarë. I kemi dhënë një rëndësi të veçantë planifikimit spitalor në rang vendi dhe në rang rajoni. Kemi përcaktuar qartë kriteret dhe mënyrën e përcaktimit të numrit të shpërndarjes së shtretërve dhe nevojave për shtretër të rinj. Pra, ky plan spitalor do ta përmbajë këtë element, mënyrën e financimit nga ana e shtetit dhe, gjithashtu, planin për zgjerimin, transformimin dhe modernizimin e strukturave spitalore.

Sipas parashikimit të tij, të bëra në këtë ligj, ne kemi përfshirë këtu koncepte të reja, por që, në fakt, përktihen si instrumente apo modele të reja që parashikon ky ligj, përpos atij që aktualisht kemi, që është modeli i autonomisë spitalore, si pjesë integrale e menaxhimit të sistemit spitalor publik, i cili garanton barazinë, aksesueshmërinë, cilësinë dhe sigurinë për shërbimet shëndetësore spitalore për pacientët. Spitalet autonome do të organizohen në formën e personit juridik/publik me te drejta, detyrime dhe përgjegjësi të përcaktuara në këtë projektligj.

Autonomia spitalore ka për qëllim të sigurojë më shumë efektivitet dhe transparencë në menaxhimin administrativ të burimeve financiare dhe të burimeve njerëzore, rritje të transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve, përmirësim, mobilizim të burimeve njerëzore

dhe atyre financiare. Për sa i përket modeleve të autonomisë së spitaleve që propozohen, dua të bëj një parantezë, një kriter për ecurinë drejt autonomisë do të jetë akreditimi i spitaleve. Ky është një proces shumë i rëndësishëm, i cili ka filluar dhe ka përfshirë në procesin e akreditimit të spitaleve njëmbëdhjetë spitale dhe shërbime publike dhe, gjithashtu, tridhjeteshtatë spitale publike dhe jopublike, ku jemi duke ecur me ritëm për të mundur që të kemi sa më shumë spitale të akredituara dhe të arrijmë në 100% të spitaleve të akredituara, të cilat të mundën më pas t'i përshtaten edhe modelit të autonomisë spitalore.

Modeli i autonomisë spitalore propozohet të jetë i përshkallëzuar në modelin e autonomisë menaxheriale, ku garantohet dhënia e autonomisë administrative, organizative dhe rregullatorë të spitaleve publike, bazuar në përcaktimin e kartës së autonomisë spitalore, si dhe modeli i autonomisë financiare, që garanton transformimin e spitaleve publike në institucione që vetëfinancohen, financohen nga buxheti i shtetit për shërbime të përcaktuara me akte nënligjore.

Karta e autonomisë do të aplikohet në mënyrë të përshkallëzuar dhe të diferencuar për çdo spital, bazuar në plotësimin e kriterëve për përfitimin e autonomisë sipas një sistemi pikëzimi, që do të përcaktohet me aktet nënligjore. Ndërkohë, autonomia spitalore apo funksionimi i saj do të ketë një procedurë për aplikim të autonomisë dhe, sigurisht, për mbajtjen e kartës së autonomisë spitalore, si dhe shfuqizimin e saj. Pra, këto janë parashikueshmëri të ligjit.

Organet drejtuese të spitalit autonom do të jenë bordi drejtues, ekipi menaxhues dhe administratori i përgjithshëm i spitalit. Ndërkohë i hapim rrugën spitalit publik autonom për të pasur një mundësi kontraktuese për shërbime të ndryshme. Ata kanë të drejtë të lidhin kontratë me palë të treta, me kompani private të sigurimeve dhe me spitale jopublike për shërbime specifike mjekësore.

Spitalet publik autonom do të kenë të drejtë të lidhin marrëveshje me shërbimet diplomatike të huaja, me organizata ndërkombëtare, korporata të huaja që veprojnë në Shqipëri për të ofruar shërbime për personelin e tyre vendor apo të huaj. Spitalet publike autonom mund të lidhin kontrata për kërkime shkencore me institucione kombëtare, të huaja për studime klinike të ndryshme dhe, sigurisht, kjo bazuar në legjislacionin në fuqi të tij. Spitalet publike autonom mund të kontraktojnë shërbime joshëndetësore me sektorin privat sipas legjislacionit.

Koncepti i spitalit autonom është që të ardhurat që do të derivojnë nga aktiviteti mjekësor dhe jomjekësor, apo të ardhura të tjera do t'i dedikohen zhvillimit të teknologjisë, zhvillimit të

infrastrukturës dhe burimeve njerëzore për shërbimet e planifikuara në planin e spitalit nga bordi i spitalit.

Një aspekt tjetër pozitiv që projektligji sjellë, në aspekt edhe të mbështetjes së ekipeve mjekësore, por, mbi të gjitha, të garancisë që stafet tona mjekësore do të vijojnë të qëndrojnë brenda sistemit publik dhe ne do të kemi garancinë e kujdesit shëndetësor ndaj qytetarëve brenda strukturave publike, është pikërisht edhe një parashikim për një tjetër instrument, që është praktika e dyfishtë. Praktika e dyfishtë është pikërisht ajo çfarë lejon mjekët në spitalet publike të kenë mundësi të ofrojnë jashtë regjimit të punës, dhe e theksoj jashtë regjimit të punës, kohës së punës dhe normave që ata kanë përcaktuar për të realizuar gjatë punës së tyre, sipas dispozitave të përcaktuara nga punëdhënësi edhe shërbime, konsulta ambulatorë për pacientë jashtë sistemit të referimit, duke krijuar atë modelin, që njihet edhe në vendet e tjera si intramoenia, pra brenda strukturës publike të ofrohet edhe shërbim jopublik, sigurisht, pa prekur regjimin e punës, sipas një regjimi të mirëpërcaktuar dhe të organizuar nga bordi i spitalit, duke këtu përfshirë kategorinë e shërbimeve të konsultave ambulatorë, tarifat përkatëse, si dhe modelin e kontratës së shërbimit me mjekun që ushtron praktikën e dyfishtë në mjediset e spitalit publik, pa cenuar ofrimin e shërbimit spitalor. Ndërkohë, projektligji përmban një serë aspektesh të tjera në lidhje me hapjen dhe mbylljen e spitaleve jopublike, me respektimin nga ana e tyre të të gjitha protokolleve mjekësore në fuqi, sigurisht, edhe sistemin e mënyrës së dhënies dhe monitorimit të shërbimeve të kryera nga spitalet publike dhe jopublike nëpërmjet sistemeve të njohura, të cilat aplikohen. Në këtë ligj ka edhe disa përcaktime të tjera në trajtën e definicionit, por edhe të dhënies së funksioneve të spitaleve, sikurse është, për shembull, funksionimi i turizmit shëndetësor, një tjetër aspekt që preket në këtë ligj dhe ne mendojmë se futet në elemente të rëndësishme, pasi u hapet edhe një derë tjetër strukturave tona spitalore publike për t'i rritur të ardhurat e tyre edhe në këtë aspekt. Ashtu sikurse e thashë, parashikimet e këtij ligji fillojnë me planifikimin kombëtar spitalor, një ndër mekanizmat më të rëndësishëm, ku fillon puna për zbatimin e këtij ligji, ku planifikohet, gjithashtu, të kemi një organ kolegjal këshillimor për të mundësuar që të kemi një strategji dhe program kombëtar në fushën e zhvillimit spitalor për të përgatitur politikat prioritare spitalore, për të përmirësuar të gjitha ato aspekte që i përkasin organizimit të shërbimeve spitalore dhe, mbi të gjitha, për të hartuar një plan, i cili i përmbush të gjitha ato kritere, të cilat lidhen me kritere demografike, socio ekonomike, barrën e sëmundshmërisë, gjithashtu për të plotësuar kërkesat didaktike dhe shkencore të edukimit

mjekësor, duke krijuar mundësinë që edhe elemente të procesit të formimit edukativ të ndodhin jo vetëm në strukturat e spitaleve universitare, por edhe në struktura të tjera spitalore që plotësojnë kushtet dhe kriteret për të qenë struktura, ku të kryhen proceset e edukimit mjekësor. Ajo çfarë është e rëndësishme, që është risi, është se kriteret organizative dhe funksionale për planin kombëtar spitalor realizohen nëpërmjet një bashkërendimi aktiv nëpërmjet strukturave të ndryshme që kontribuojnë në krijimin e sistemit spitalor kombëtar. Këtu dua të ndalem në një element që besoj se ka rëndësi që lidhet me mënyrën e organizimit të sistemit spitalor dhe me risitë që parashikon ky projektligj, ku për herë të parë do të kemi të përshkruar dhe të modeluar qendrën spitalore rajonale që i përket më shumë se një qarku, për shërbime specifike që rajoni mund të ketë nevojë dhe ku alokohen burimet njerëzore dhe financiare në një spital që përmbush edhe nevojat spitalore të qytetarëve, të cilët mund të jetojnë në qarqet e afërta. Këtu kalojmë në një tjetër element të rëndësishëm, i cili ka lidhje me shërbimet spitalore të integruara, duke vendosur në një administrim unik burimet njerëzore financiare të infrastrukturës dhe të organizimit territorial, pra të kujdesit terciar, sekondar dhe atij në rang bashkie apo edhe qarku. Pra, ashtu sikurse e thashë, ky është një ligj, i cili është i mirëlaburuar, i mirëmenduar, brenda tij ka mësim të mësuara nga praktika tashmë të zbatuara apo të implementuara të vendeve të zhvilluara, duke qasur këtu një model, i cili ka koherencë, është i zbatueshëm për rrethanat dhe për momentin ku gjendet, Shqipëria por, nga ana tjetër, edhe projektton edhe një vizion për të ardhmen, për sistemin spitalor në vendin tonë. Pra, si risi e autonomisë spitalore, e cila është modeli i ri për menaxhimin më efektiv dhe për shërbimin më cilësor të spitaleve, që rrit edhe kompeticionin në strukturat e shërbimit spitalor publik, janë burimet e financimit, të cilat praktikisht optimizohen. Këtu përfshihen të gjitha burimet që lidhen edhe me të ardhura të krijuara nga shërbime me palë të treta, gjithashtu, edhe mënyra e aplikimit të praktikës së dyfishtë apo edhe korsive preferenciale brenda strukturave publike dhe mënyra e se si mund të administrohen këto të ardhura, të cilat i shkojnë pikërisht mbështetjes së pacientëve për shërbime klinike dhe joklinike. Ne me këtë ligj zgjerojmë edhe kategoritë e spitaleve, nuk ngelemi në spitalet apo në ato strukturat rixhide të shërbimit sot, por hapemi në mentalitetin e organizimit të shërbimit mbi baza të eficiencës dhe të produktivitetit të spitaleve, duke krijuar mundësinë që spitalet, të cilat u përgjigjen një popullate apo ndryshimeve demografike, të mundet të organizohen në nivel qarku që të ofrojnë më shumë shërbime për popullatën, nga ana

tjetër, të kenë njësitë shpenzuese të organizuara në mënyrë të tillë që të kemi sa më shumë kosto dhe efektivitet.

Nga ana tjetër, besoj se është e rëndësishme që ka një përfshirje të të gjitha strukturave organizative të spitaleve, qofshin ato që lidhen me autonominë spitalore, ku për herë të parë fusim administratorin e spitalit si risi në organizmin territorial të spitaleve autonome dhe bordin që do të jetë përgjegjës në këtë aspekt, gjithashtu, edhe ofrimin e shërbimit të turizmit shëndetësor që u jep të drejtën spitaleve publike për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për trajtime diagnostikime për të gjithë shtetasit e huaj, të cilët duan të marrin shërbime specifike, por ato do të jenë të kostifikuara dhe të tarifuara sipas metodologjisë unike që do të hartojmë në kuadër të këtij projektligji.

Sigurisht, ajo që është e rëndësishme, është që ndikimi qoftë për sa aspekteve sociale, por edhe atyre ekonomike do të jetë shumë i madh, pasi kjo do të na rrisë ne burimet e financimit të spitaleve autonome, do të rrisë nxitjen dhe rritjen e të ardhurave sekondare të tyre dhe do të ketë një ndikim pozitiv për sa i përket mbështetjes financiare të personelit shëndetësor nga spitalet autonome, e cila do të bëhet mbi bazën e performancës.

Për sa i përket ndikimit social, do të ketë një rritje të forcimit të besimit mjek-pacient edhe në aspektin e shërbimeve, të cilat do të rriten dhe do të fuqizohen afër vendbanimit, pra duke krijuar më shumë garanci që të ofrohen më shumë shërbime afër vendbanimit për qytetarët. Ajo që është e rëndësishme, është se do të ketë një rritje të të ardhurave të mjekëve brenda strukturës publike nga praktika e dyfishtë, një instrument i ri, që ka parashikuar ky projektligj. Unë po e mbyll këtu dhe jam në dispozicion për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjala për zonjën Denaj, në cilësinë e relatores.

Ndërkohë, kam dy kërkesa për pyetje deri tani, por fjala për ju.

Anila Denaj – Faleminderit për prezantimin!

Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, sipas procedurave të parashikuara në nenet 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

Është e panevojshme të shkojmë në të gjitha detajet, megjithatë kam dëshirë të parashtojë disa elemente të rëndësishme të këtij projektligji.

Së pari, qëllimi i projektligjit lidhet ngushtë me sigurimin dhe garantimin e ofrimit të shërbimit spitalor në vendin tonë, bazuar në standardet e cilësisë dhe sigurisë së ofrimit të kujdesit spitalor, duke synuar respektimin e së drejtës themelore të shtetasve për shërbime shëndetësore të aksesueshme dhe cilësore.

Projektligji parashikon autonominë spitalore, si pjesë integrale të menaxhimit të sistemit spitalor publik. Autonomia spitalore është një formë e decentralizimit të të drejtave të vendimmarrjes financiare dhe administrative nga strukturat e qeverisjes së përgjithshme të spitalet publike. Kjo autonomi jepet nga ministri përgjegjës për shërbimin spitalor dhe dokumentohet nëpërmjet Kartës së Autonomisë Spitalore. Modelet e autonomisë së spitaleve, të cilat përcaktohen në Kartën e Autonomisë Spitalore, janë:

Modeli i autonomisë menaxheriale, i cili mundëson dhënien e autonomisë administrative, organizative dhe rregullatore spitaleve publike dhe modeli i autonomisë financiare, i cili mundëson transformimin e spitaleve publike në institucione që vetëfinancohen, financohen nga buxheti i shtetit, për shërbime të caktuara nga Këshilli i Ministrave dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Karta e Autonomisë Spitalore do të aplikohet në mënyrë të përshkallëzuar dhe të diferencuar për çdo spital, bazuar në plotësimin e disa kritereve të miratuara me VKM dhe sipas një sistemi pikëzimi që do të përcaktohet me urdhër të ministrit.

Projektligji është në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, specifikisht me objektivin 3,8, i cili parashikon arritjen e mbulimit universal shëndetësor, duke përfshirë mbrojtjen e rrezikut financiar, aksesin në shërbimet cilësore të kujdesit shëndetësor thelbësor, si dhe aksesin në barna dhe vaksina thelbësore të sigurta, efektive, cilësore dhe të përballueshme për të gjithë. Projektligji pritet të ketë ndikim në ekonomi dhe ky ndikim të jetë pozitiv, pasi rrit burimet e financimit të spitaleve autonome publike dhe nxit rritjen e të ardhurave të tyre. Gjithashtu, projektligji ka ndikim social, pasi parashikon rritje të besueshmërisë së qytetarëve në shërbimin spitalor, gjithashtu, siç e tha ministrja, pritet të sjellë edhe rritjen e konkurrencës ndërmjet spitaleve publike e private dhe orientimin më të madh të qytetarëve drejt spitaleve publike.

Unë ju përgëzoj, sepse ky është një ligj shumë avangardë dhe të gjitha këto objektiva të jenë në shërbim të qytetarëve për shërbime të aksesueshme, siç e tha në shërbim universal, por edhe cilësore. Jam e bindur që koha në dispozicion prej 9 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji

për të gjitha aktet normative është një kohë relativisht e shkurtër dhe përgjegjësia për nxjerrjen e këtyre akteve duket se është një peshë e madhe në shpatullat tuaja, por, duke menduar rëndësinë që ka ky projektligj në fillim të zbatimit, mendoj sedo të jetë një sforco e justifikuar.

Nëse më lejoni, zoti Kryetar, kam vetëm dy komente, të cilat më shumë janë për sqarim.

Së pari, duke filluar nga konteksti i objektivit që ju e thatë pak më parë, që rrit transparencën në shumë shërbime, të cilat sot mund të ofrohen dhe gjithmonë ofrohen në formën më të duhur të mundshme, kemi pasur edhe raste abuzimesh apo afera korruptive, por me këtë ligj shpresa është që këto të eliminohen. Megjithatë, cili do të jetë ai sistem kontrolli dhe cili do të jetë enti i jashtëm nga strukturat e brendshme të spitaleve që do të operojë? A do të ketë rolin, siç e ka pasur më parë FSDKSH-ja në raport me kontrollin, apo do të ketë një sistem të ndryshëm? Sigurisht, kjo mund të jetë te vendimet e Këshillit të Ministrave, por a është menduar që ky sistem kontrolli të jetë më i përshkallëzuar dhe të sigurojë principin e katër syve që të mos jetë vetë institucioni i cili siguron këtë autonomi financiare dhe me menaxhimi dhe më pas të jetë edhe ai i kontrollit?

Së dyti, ajo që lidhet me autonominë financiare, në nenin 24, sidomos në pikën 2, ju i bëni referencë edhe faktit që të gjitha burimet financiare, që sigurohen, u nënshtrohen rregullave të menaxhimit financiar të fondeve publike, duke besuar unë, lë të nënkuptoj që aplikimi i inspektimit financiar është në përputhje me këtë frymë, por në të njëjtën pikë të nenit 24, pra pika 2 e nenit 24, thoni: “Janë të kontrollueshme nga ministri përgjegjës për shërbimin spitalor” kur, në fakt, për këtë pikë është ministri i Financave ose Ministria e Financave. Thjesht për ta qartësuar nëse nuk ka mbivendosje apo është thjesht një kontekst vokabular juridik që e përcakton këtë qartazi brenda së njëjtës pikë.

Faleminderit dhe ju uroj shumë suksese në këtë sfidë!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Denaj!

Fjalën e ka zonja Koti, më pas e kanë fjalën zonja Dhima dhe zoti Xhexhili.

Sorina Koti – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë edhe më herët, kur kemi pasur ministren e Financave dhe zonjën Manastirliu, kur kemi bërë diskutime për buxhetin e shtetit për vitin 2022, kam ngritur shqetësimin për mungesën e qendrave shëndetësore, sidomos në njësitë administrative. Me projektligjin, që ju po sillni, përsëri po e ndani në disa spitale terciare dhe sekondare, kur jo më pak se para një jave në disa njësi administrative të Bashkisë së Korçës, përsëri ka mungesa të qendrave shëndetësore, ka

mungesa të mjekëve, ka mungesa të mjekëve specialistë në Spitalin Rajonal të Korçës, dhe këtë e them ngaqë jetoj vetë në atë qytet dhe përballëm shpeshherë me spitalin e qytetit të Korçës. Dua t'i përgëzoj mjekët, të cilët, edhe pse me pamundësinë e fondeve dhe të aparaturave, herë pas here bëjnë mrekulli për shkak të situatës ku janë, por ky projektligj nuk sjell diçka që të rrisë cilësinë në shërbim. Kemi nevojë të rritim cilësinë dhe fondet. Ne kemi parë se si janë ulur fondet nga Ministria e Financave drejt Ministrisë së Shëndetësisë nga viti 2021 për vitin 2022, kemi parë se si janë ulur fondet për qendrat shëndetësore, e kemi diskutuar, madje kemi pasur edhe debate në komision për këtë çështje. Ajo që më shqetëson, është se ju thoni se do të ketë një autonomi spitalore, ku do të ketë fonde nga buxheti i shtetit, do të ketë fonde nga donacione dhe nga pushteti vendor. Unë dua të di si do të kontrollohen këto fonde? Sa të detyruara do të jenë bashkitë, kur nuk kanë fonde për të menaxhuar shërbime, të cilat i kanë marrë nga decentralizimi fiskal dhe nuk i kanë zbatuar ende për këta 6 vjet? Si do të ndikohen, ose si do të monitorohen, apo ndoshta do të detyrohen të japin fonde për spitalet rajonale, sekondare apo qendrat shëndetësore, sepse ne e dimë gjendjen e buxheteve të bashkive, pra se sa të cenuara janë dhe shërbimet që do t'u ofrojnë qytetarëve? Nëse do të kemi donacione, sa transparentë do të jetë fondi i donacionit, sa do të jetë limiti; nëse do të ketë abuzime më tej me përfitimet e kontratave, që mund të kenë donatorët kundrejt shërbimeve spitalore publike. Pra, këtu kemi disa çështje, të cilat janë goxha për t'u diskutuar dhe në interes të publikut.

Ju lutem, dua një përgjigje kundrejt cilësisë së shëndetësisë, si do të menaxhohen fondet, si do të kontrollohen dhe sa mund t'i shmangim abuzimet me këto fonde?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Do ta bëjmë pyetje-përgjigje, meqenëse janë pak?

Ogerta Manastirliu – Faleminderit!

Dua t'i përgjigjem në mënyrë koncize koleges Denaj dhe koleges që sapo e mori fjalën.

Me shumë të drejtë kërkohet se cilat do të jenë sistemet e kontrollit, sepse, në fakt, për të ndërtuar një kuadër ligjor, i cili është me të vërtetë avangardë dhe ofron mënyra të reja të aplikimit të administrimit financiar, kërkohet që të ketë edhe sisteme shumë efektive të kontrollit.

Për sa u përket shërbimeve ndaj pacienteve, ne kemi ndërtuar dy instrumente, që janë instrumente recente.

Së pari, është auditi klinik, auditi klinik është një instrument, i cili garanton që shërbimet klinike brenda spitaleve të auditohen, në mënyrë që ne të kemi garancinë që shërbimet që ofrohen, të jenë ato shërbime që përkufizohen brenda të gjitha protokolleve mjekësore, *guideline-ve* klinike që përmbushin ato kritere dhe kushte, të cilat ne i kemi parashkruar në këto protokolle. Ndërkohë që Agjencia e Standardeve dhe Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Spitalor është një tjetër strukturë, e cila është krijuar para disa muajsh, dhe ka për qëllim të gjithë kontrollin e atyre elementeve që lidhen me transparencën, që lidhen me standardet, që lidhen me procedurat standarde operacionale të spitaleve, të cilat më pas sjellin dhe akreditimin e spitaleve dhe shërbimeve të tyre.

Për sa u përket instrumenteve të kontrollit financiar, do të vijojë të jetë Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sepse ky fond është struktura, e cila do të vijojë të financojë shërbimin spitalor, por, nga ana tjetër, këtu i referohem edhe nenit 24, që ju, me të drejtë, e ngritët, edhe Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet auditimit të saj të brendshëm kontrollon, përpos Ministrisë së Financave që e ka detyrë organike të saj, pikërisht menaxhimin e fondeve që vijnë jo vetëm nga buxheti i shtetit, por edhe nga donatorët. Këtu i kthej përgjigje edhe koleges për sa u përket fondeve që mund të vijnë nga donacionet apo edhe nga palët e treta. Që të gjitha fondet që hyjnë në thesar, në buxhet, por edhe në banka të nivelit të dytë, janë fonde të cilat i nënshtrohen legjislacionit në fuqi, kur vjen fjala për përdorimin e tyre, kështu që ligji i ka të ngritura instrumentet.

Mënyra dhe modeli i aplikimit të autonomisë spitalore vjen me një qasje të re për sa i përket mënyrës së organizimit të spitaleve, kështu që mundësinë e financimit për burimet e financimit të spitaleve të mos e ngatërrojmë me reformën e decentralizimit dhe aspektet që lidhen me pushtetin lokal dhe përgjegjësitë që ka pushteti lokal. Burimet e financimit, ku janë futur edhe bashkitë, janë burime të mundshme financimi, pra, nëse do të vijë një moment që bashkitë do të alokojnë fonde, këtu është hapur mundësia dhe kjo mundësi nuk është hapur me këtë ligj të ri që po e bëjmë sot, por ka qenë e hapur edhe me ligjin e vitit 2003, që, praktikisht, jemi edhe sot, por që do të shfuqizohet nga ligji i ri që do të miratojmë së bashku, por krijohet mundësia e financimit dhe aty ka disa elemente që financojnë spitalet, pjesë e të cilave janë edhe bashkitë që nuk kemi pse t'ua mohojmë të drejtën që, nëse do të duan të financojnë, shumë mirë, ashtu sikurse financojë edhe struktura të tjera, palë të treta apo donacione mund të vijnë për t'i mbështetur spitalet tona.

Nga ana tjetër, për sa i përket cilësisë, theksoj se ky ligj prek të gjithë sistemin spitalor dhe për arsye të analizës së thellë që ne i kemi bërë gjithë sistemit spitalor, për arsye të analizës që i kemi bërë legjislacionit aktual të sistemit spitalor, duke i vlerësuar të gjitha aspektet e funksionalitetit dhe zbatimit të ligjit dhe analizës që i kemi bërë sistemit në raport me shfrytëzimin e kapaciteteve tona aktuale, ne kemi arritur në konkluzionin që na duhet një ligj i ri, i cili të ndërtojë mekanizma që të mundësojnë që spitalet tona të jenë më autonome nga pikëpamja e organizmit të burimeve njerëzore dhe financiare. Ndaj autonomia spitalore ka dy shkallë: ka shkallën e autonomisë spitalore menaxheriale dhe shkallën e autonomisë spitalore financiare.

Po marr rastin e spitalit të Korçës. Ne kemi mbi 42 njësi shpenzuese, që financohen direkt me kontrata të Fondit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për sa u përket spitaleve. Kemi këtu edhe spitale të vogla, për shembull, në Korçë kemi Devollin, kemi Kolonjën, kemi Pogradecin, që është spital bashkiak.

Nga mënyra se si vjen ky ligj, se si konceptohet, kemi mundësi që spitale të vogla, të cilat sot ofrojnë shërbime 24-orëshe, shërbime ditore dhe të urgjencës, të mundet që t'i optimizojnë për këto shërbime. Pra, nuk kemi ne pse t'i mbajmë të gjitha shërbimet në një spital që e dimë që i ofron një komuniteti, i cili, në aspekte të zhvillimit të shërbimeve, s'do t'i plotësonte dot, nëse ne nuk do t'i kishim dhënë garanci që Spitali Rajonal i Korçës, me burimet njerëzore që ka, nëpërmjet një kalendari të shërbimeve, të mundet t'i afronte edhe Devollit, edhe Ersekës, përkundrejt pagesës për performancë, mjekë të cilët të shkojnë në mënyrë ciklike për të ofruar shërbime të konsultave, shërbime të kujdesit spitalor ditor, sipas protokolleve të miratuara, prandaj këtu krijohen koncepte të reja, sikurse është spitali ditor, sikurse është qendra rajonale spitalore, ku mund të ketë shërbime të specializuara që ofrohen në një qark dhe qarqet përreth mund të shkojnë në atë spital për të marrë një shërbim spitalor. Për shembull, okulistika, nëse investimi për një qark nuk e justifikon popullatën në atë qark, atëherë ne ndërtojmë një shërbim të specializuar. Po marr si shembull kataraktin, megjithëse tanimë nuk është ndërhyrje aq e vështirë, pra kataraktin e kemi në spitalin e Shkodrës, do ta fillojmë së shpejti dhe, derisa ta fillojë Lezha, të gjithë qytetarët e Lezhës shkojnë në Shkodër për ta marrë këtë shërbim, kështu krijojmë një shërbim specialistik në një qendër rajonale të specializuar.

Së pari, këto zbrazin Tiranën nga fluksi i madh i qytetarëve që vijnë vetëm në Tiranë dhe ne ndërtojmë kapacitetet dhe premisat për të bërë bashkë mjekët më ekspertë në pole të caktuara,

duke qenë se ka ndryshuar situata demografike, por ka ndryshuar edhe infrastruktura, është bërë më e shpejtë lëvizja nga një qark në tjetrin dhe patjetër që ulin shpenzimet nga xhepi i qytetarëve.

Mekanizmi i referimit të krijuar apo të vendosur si instrument në këtë ligj krijon premisa që qytetarët të marrin shërbime afër vendbanimit, por edhe llogaridhënia dhe transparenca e shpenzimeve që bëjnë spitalet për shërbimet e kryera të jetë më e madhe dhe më e kuantifikuar, në raport me përgjegjësitë që ato kanë për shërbimet e ofruara. Ndaj jemi besimplotë, edhe pse është një sfidë shumë e madhe, se ky ligj në vetvete është një revolucion për sistemin. Vende të ndryshme, si Spanja, Portugalia, Polonia, kanë vite e vite që janë duke e zbatuar dhe duke e shtrirë me shkallë autonominë spitalore, sepse janë procese transformuese edhe për mendjet e të gjithë atyre që punojnë në sistem, se është proces transformues autonomia dhe dhënia e përgjegjësi.

Nga ana tjetër, ne do të garantojmë që spitalet tona të fillojnë të kenë produktivitet, bazuar në kostot e shërbimit dhe në ato protokolle, të cilat ne tashmë kemi filluar dhe i kemi linjësuar, duke i përfshirë brenda punës sonë dhe punës së agjencive të ngritura rishtazi për të organizuar punën në sistemin shëndetësor.

Sigurisht, qasja e qendrave rajonale, ku spitalet e konsideruar si spitale satelit, të menaxhuara nga një spital mëmë, është një qasje shumë më produktive në raport me shërbimet dhe, mbi të gjitha, është një qasje shumë më efektive në raport me menaxhimin e burimeve njerëzore që ne kemi dhe do të kemi në territor. E rëndësishme është që mjekët do të jenë të mirëpaguar dhe, përveç rritjes së vazhdueshme që qeveria bën për pagat, do të kenë mundësi të pagesës për performancë për mjekët, kjo edhe nga praktikatat tona të mira, sikurse është bonusi i mjekëve apo praktika e patronazhimit, të përkthyer në instrument financiar që ne sot e kemi të realizuar, por që kërkohet një formalizim dhe kërkohet të futet kjo qasje e re e modelit të autonomisë spitalore, pikërisht për këtë qëllim.

Pilotimi i autonomisë spitalore, duke e futur në një kanal shpejtësie, ndërkohë që ne përgatitemi që për 9 muaj të bëjmë gjitha elementet e akteve nënligjore, por edhe të instrumenteve që duhen për zbatimin e ligjit, do të pilotohet në Spitalin Memorial Fier, si një spital, i cili ka premiset për të realizuar autonominë menaxheriale dhe më pas atë financiare, por edhe për të mësuar gjatë pilotimit të autonomisë në këtë spital.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zonja Dhima, zoti Xhelili, zoti Shehu, zonja Koliqi.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre, për prezantimin e projektligjit!

Duke u nisur nga eksperiencia ime në drejtimin e spitalit rajonal, personalisht, e vlerësoj si shumë të rëndësishëm dhe shumë të domosdoshëm ardhjen e këtij projektligji dhe miratimin e tij, pasi ai do të sjellë një ndryshim në veprimtarinë e shërbimit spitalor në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si në mënyrën e organizimit, ashtu edhe të administrimit, njëkohësisht edhe menaxhimin dhe financimin e të gjitha institucioneve të shërbimit shëndetësor.

Njëkohësisht, nëpërmjet këtij ligji përcaktohen rregullat e qarta për ushtrimin e veprimtarisë së të gjitha institucioneve shëndetësore, si dhe për mbylljen e atyre spitaleve jopublike dhe publike, të cilat nuk justifikojnë kostot e tyre.

Në fjalën tuaj ju e thatë që nëpërmjet këtij projektligji spitalet sigurojnë një autonomi në përdorimin e të ardhurave të aktivitetit mjekësor dhe jomjekësor ose edhe të ardhura të tjera, të cilat krijohen nga institucione shëndetësore. Këto të ardhura do të përdoren për blerjen e mallrave, shërbimeve, njëkohësisht edhe investimeve në infrastrukturë, në teknologji, në burime njerëzore, të cilat janë shumë të domosdoshme, pavarësisht se gjatë këtyre viteve qeverisje nga ana e qeverisë shqiptare dhe juve si ministre dhe ministrisë që ju përfaqësoni, janë kryer investime shumë të rëndësishme në ofrimin e një shërbimi sa më cilësor kundrejt shtetasve shqiptarë, por jo vetëm. Gjithashtu, më vjen mirë që kjo autonomi vendore ose ky projektligj do të aplikohet fillimisht në Spitalin Rajonal Memorial të Fierit, i cili ofron një shërbim me standarde dhe aty do të zbatohet për herë të parë autonomia spitalore, njëkohësisht, pjesa e menaxhimit në bazë të marrëveshjes që qeveria shqiptare ka lidhur me qeverinë turke.

Në fjalën tuaj ju thatë që autonomia spitalore do të zbatohet nëpërmjet këtij ligji. Pyetja ime është se si do të realizohet kjo autonomi spitalore dhe si do të aplikojnë spitalet për marrjen e kartës së autonomisë spitalore?

Gjithashtu, në projektligj përcaktohet që anëtarë të komitetit për planifikimin kombëtar spitalor zgjidhen në funksion për një mandat 3-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Kush e ka të drejtën që t'i zgjedhë këta anëtarë të këtij komiteti?

Njëkohësisht, pjesë e projektligjit është edhe plani kombëtar spitalor, i cili është një dokument që përcakton kapacitetet spitalore kombëtare, bazuar këto në kriteret territoriale,

demografike, social-ekonomike, barrës së sëmundshmërisë, si dhe për të plotësuar kërkesat didaktike dhe shkencore të edukimit mjekësor. A keni ju një plan konkret për hartimin e këtij plani spitalor?

Një pikë tjetër e këtij projektligji është edhe financimi dhe burimet e tij, të cilat janë burime financimi që sigurohen nga buxheti i shtetit, njëkohësisht edhe nga institucionet e sigurimeve shëndetësore, pushteti vendor, donatorët vendas dhe të huaj, të ardhura të krijuara nga shërbimet me palë të treta dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

Çfarë përfaqëson kjo “të ardhura të tjera të ligjshme”, ose cila është ideja juaj se çfarë do të përfshihen në këto të ardhura?

Duke ju uruar suksese në implementimin e këtij projektligji, unë jam besimplotë që ligj “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” do të sjellë një menaxhim më të mirë të financave të institucioneve shëndetësore.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zonja Ministre!

Ogerta Manastirliu – Faleminderit!

Komiteti i Planifikimit Spitalor është një komision i cili do të ketë për përgjegjësi, të hartojë planin kombëtar spitalor, përzgjedhja e të cilit do të bëhet në bazë të profesionistëve të fushës në të cilën kanë informacionin, por kanë edhe ekspertizën për të ndërtuar një plan të ri kombëtar spitalor, ose më saktë, planin e parë kombëtar spitalor që do të kemi bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

Është e vërtetë që ne tashmë, paralelisht, kemi filluar një punë për të pasur një draftplan me strukturat dhe kapacitetet e Ministrisë së Shëndetësisë, por komiteti, që do të angazhohet për miratimin e këtij plani, do të ketë në përbërje të tij ekspertë të cilët do të na japin një asistencë dhe, gjithashtu, të kenë bekgroundin e duhur për të hartuar një plan që do të përcaktojë numrin e shtretërve, nevojën për shtretër të rinj, specialitetet kryesore në rajone të caktuara dhe qarqe të caktuara, gjithashtu, edhe organizimin territorial të spitaleve, sigurisht edhe nevojën më pas për investime në shërbime.

E rëndësishme është që deri më sot ne kemi pasur një plan, sigurisht plan të brendshëm, ku kemi bazuar të gjithë punën tonë.

Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 20-30 është një tjetër udhërrëfyes në të gjithë punën për sa i përket organizimit të sistemit shëndetësor, në veçanti atij spitalor, ndërkohë që plani i

racionalizimit të spitaleve, që është hartuar me asistencën e Bankës Botërore, është një plan i cili na ka garantuar që çdo shërbim dhe çdo investim që sot po e bëjmë (dhe këtu lidhemi edhe me investime recente, sikurse, për shembull, modeli i spitalit bashkiak të Kurbinit, që është model me të gjithë parametrat që edhe konsulentët tanë nga Banka Botërore na kanë ofruar nëpërmjet planit të racionalizimit) i përmbush pikërisht këto kritere.

Pra, nisemi nga një bazë, që është plani i racionalizimit spitalor dhe shkojmë në një nivel të ri që është pikërisht plani kombëtar spitalor, që ne do ta miratojmë nëpërmjet ekspertizës përkatëse dhe komisionit përkatës.

Për sa i përket elementit të të ardhurave nga qiratë apo të të ardhurave të tjera, mund të nënkuptojmë edhe të ardhurat nga qiratë që spitali mund të garantojë dhe këto janë të gjitha të ardhura, të cilat shkojnë në burime dytësore të të ardhurave të spitalit dhe përdoren sipas metodologjisë së përdorimit të të ardhurave, kryesisht shkojnë për infrastrukturë spitalore, për pajisje biomjekësore dhe burimet njerëzore, edukimin në vazhdim të tyre.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Xhelili!

Alban Xhelili – Faleminderit!

Së pari, doja të falënderoja edhe ministren, jo vetëm për shpjegimin shumë shterues që i bëri këtij projektligji, por edhe për disa pika të tjera që preku dhe ishin me shumë interes, të paktën, për mua, siç ishte çështja e mënyrës së organizimit të spitaleve në bazë të specialiteteve dhe nevojave të komunitetit, pra për të mos krijuar në çdo qendër të vogël spitale që mendojmë se na i kryejnë të gjitha shërbimet, por në fund na japin vetëm shërbime gjysmake. Kjo ishte një pjesë e sqarimit që besoj se jo vetëm për mua, por për të gjithë opinionin paraqet interes.

Së dyti, unë këtë projektligj nuk do ta etiketoja si një projektligj si një revolucion ose si një koncept i ri në sistemin spitalor. Këtu nuk flas thjesht vetëm për autonominë, por flas në tërësi për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të të gjitha strukturave spitalore, ku një element i rëndësishëm është edhe pjesa e pagesës mbi bazë performance. Po të shikojmë këtë pagesën mbi bazë performance, nuk duhet ta shohim si term, por duhet ta shohim se në strukturat më të rëndësishme spitalore dhe, kur flas për struktura të rëndësishme, flas për Perëndimin, qoftë edhe vende si Kanadaja. Pagesa mbi bazë performance e ka ndryshuar komplet formën e funksionimit të sistemit shëndetësor, duke sjellë jo vetëm rritje të cilësisë, por ka sjellë edhe një dëshirë të mjekëve për të qenë në sistemin shëndetësor publik dhe jo atë privat.

Nga kontaktet që kam pasur me mjekë në disa shtete kanë qenë shumë drastikë, duke ma kanë dhënë si zgjidhjen e vetme për të përthithur personelin shëndetësor në strukturat shtetërore dhe për të mos t'i lënë si ajo pula pa kokë, duke mos ditur nga të ikin këtej apo andej. Kur përmenda fjalën “revolucion”, u duk si diçka e madhe, por në këtë prizëm e shoh.

Gjithsesi, kam 2 pyetje dhe disa sugjerime. Po të shohësh nenet 4 dhe 11 të projektligjit, në nenin 4 jepen parimet e ofrimit të shërbimit shëndetësor dhe thuhet: “Universaliteti dhe solidariteti janë dy parimet bazë”. Në nenin 11 thuhet: “Për ofrimin e shërbimit spitalor për shtetasit e huaj”, ndërsa në pikën 1 përcaktohet: “Spitalet publike dhe jopublike janë të detyruara t’u ofrojnë ndihmë mjekësore të huajve, të siguruar ose jo, që kanë nevojë për shërbim urgjence”. Në pikën 2 thuhet: “Po, ky shërbim do të ofrohet, por sipas tarifave të përcaktuara nga organet drejtuese të vetë spitalit”. Po në rastet kur ata nuk kanë mundësi dhe nuk mund të paguajnë?

Kam edhe diçka tjetër që lidhet me atë që sapo ju thashë pak më sipër. Në nenin 15 është përcaktuar mekanizmi i referimit, si dhe kush do ta bëjë referimin për pacientët dhe se ku duhet të shkojnë. Unë them që mekanizmi i referimit duhet parë pak më ndryshe, pra referimi nuk u duhet lënë në dorë strukturave të shërbimit parësor, por edhe pacientëve, pasi duhet të jenë vetë pacientët, pra kur flitet për strukturat autonome, që të zgjedhin mjekun dhe strukturën në të cilën do të shkojnë. Jam duke folur gjithmonë për sektorin publik, duke rritur në këtë mënyrë dëshirën e mjekëve për t’u kualifikuar më tej dhe për të shërbyer në sektorin publik.

Pra, një pacient që zgjedh mjekun patjetër i rrit performancës mjekut, por edhe pagesën dhe dëshirën për të qenë punonjës i atij spitali, për këtë arsye e lidha nenin 15 me nenin 17. Sipas mendimit tim, pagesa mbi bazë performance, edhe ky është një sugjerim, nuk duhej të ishte vetëm në strukturat me autonomi, por mund të ishte edhe te strukturat që mbështeten nga ne, pra nga buxheti i shtetit. Edhe një mjek që punon në një spital, që për arsye të ndryshme nuk akreditohet dhe nuk e ka autonominë mund të kishte edhe një diferencim, por kjo është një pikë tjetër.

Spitalet që kanë autonomi e kanë më të thjeshtë, këtë e kuptoj, për sa kohë është vendosur kjo.

Ju komplimentoj për projektligjin dhe përveç sugjerimeve që kisha dua të falënderoj edhe relatoren për pasqyrimin e këtij projektligji, si dhe t’ju uroj punë të mbarë!

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Xhelili!

Fjalën e ka zoti Shehi.

Më pas fjalën e ka zonja Koliqi.

Para se të kalojmë në votim do t'ia jap fjalën ministres për të na dhënë disa shpjegime për pyetjet që u bënë.

Dashmir Shehi – Kam 2-3 pyetje të vogla dhe një lloj arsytimi. Është bërë mirë që është bërë ligji, është një fushë e re dhe në mos një ditë një ditë tjetër do t'i futeshim kësaj pune. Unë kam qejf të jetë “revolucion”, ashtu siç e tha edhe zotëria, por do të kënaqesha edhe me evolucion.

Këtu nuk futet i gjithë shërbimi shëndetësor, sepse është vetëm spitalor, pra kemi edhe shumë gjëra të tjera përpara. Sa i takon shërbimit spitalor, është vetëm shërbimi publik që do t'i nënshtrohet kësaj, por unë gjykoj që disa nga ato rregullat duhet të jenë të detyrueshme edhe për spitalet private.

Për mua do të ishte më mirë ta fillonim me autonominë administrative jofinanciare, duke e menduar mirë atë rastin e Fierit. A e dini pse po ju them jofinanciare? Sepse autonomia financiare është e lidhur me shumë reforma të tjera. T'ju bëj një pyetje: nga do të vijnë paratë që ky do të bëhet më i mirë, doktorët do të paguhen më shumë e të tjera? Nga do të dalin këto para, sepse dy janë burimet: ose paratë e buxhetit, ose paratë e institutit shëndetësor, të dyja këto janë të ligjshme. Janë edhe para të tjera që janë të paligjshme dhe që ua japim doktorëve nën dorë, të cilat, nëse do t'i bëjë të ligjshme, duhet t'u vëmë një *fee* për qytetarët. A do të jetë më ky shërbim publik dhe falas (në të vërtetë falas nuk ka qenë ndonjëherë), atëherë nga do të vijnë këto para? Po t'u japim autonominë e plotë, doktorët do të fillojnë të mblidhen në darkë dhe të thonë: “Te Spitali Amerikan marrin 3 mijë dollarë, a e vëmë 1500 ne?” Në këtë mënyrë dalin disa para, por shërbim publik ky nuk është më, aq më tepër një shërbim, siç e keni pretenduar ju, falas.

Para se t'i futeni kësaj fushe, për mua nuk do të jetë e suksesshme, hajdeni ta provojmë për 1 ose 2 vjet autonominë administrative, e cila mirë ose keq do t'i shkëpusë spitalet nga dhuna e politikës, e shefit të partisë e nga muhabetet e tjera. Ky është hapi i parë dhe më pas kjo duhet të shkojë paralel me një reformë të sigurimit shëndetësor.

U bënë gati 30 vjet që ne paguajmë 3,7% të sigurimeve shëndetësore dhe po t'i mbledhësh bëhen 50-60 milionë. Me këto do të bëhet autonomia spitalore dhe reforma? Asnjë qeveri nuk ka pasur kurajë të ngrejë sigurimet shëndetësore, të cilat në të gjithë botën janë burimi

kryesor mbi të cilin mbështeten, sepse nëse do t'u japim autonomi, atëherë duhet t'u japësh edhe disa para më shumë këtyre zotërinjve.

Ligji për dhurimet, donacionet, vërxani emrin si të doni, një pjesë, të paktën 30% e ca e shërbimit shëndetësor në Amerikë mbahet me këtë punë. Pse mbahet me këtë, mos janë burra më të mirë amerikanët? Brenda sistemit të fiskut i kanë dhënë këtë mundësi, pra dërgojuani paratë në spital dhe zbritjuani nga taksat. Edhe ju nëse prisni ndonjë lloj donacioni nga kush e prisni, ku janë këta burrat e mirë në Shqipëri që të japin para për spitalet?

E gjithë autonomia financiare duhet të shoqërohet me një bllok reformash në qoftë se doni ta lançon me një lloj sukcesi. Kur lëshohet një varkë në ujë shikohet sa vrima ka, a merr apo jo ujë? Kemi gati 30 vjet që bëjmë reforma në shëndetësi, më bëhet qejfi që ende shoh nëpunës të vjetër, sa herë jemi nisur ta bëjmë këtë, por ende nuk kemi arritur gjë.

Ju po thoni edhe për atë çështjen e bankës dhe se do të rajonalizohen shërbimet e të tjera. 30 banka ka këtu dhe ne kemi bërë spitalet rajonale, përqendrim të shërbimit parësor, shërbim ambulator e të tjera. Këto gjëra nuk bëhen lehtësisht.

Unë do t'ju sugjeroja ta bëjmë me faza, të bëjmë reformën administrative në mënyrë që doktorët të mësojnë të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, të përcaktojnë ata që janë më të zotë, të krijohet hierarkia brenda një spitali, sensi i autonomisë që shefat të mos i vërë më ministri dhe as drejtorët e ministrive dhe më pas të kalojmë në një fazë të dytë nëse do të jetë e mundur. Pse? Ti hapësirën ligjore e ke lënë aty, kështu që një spital që ka burime të mjaftueshme të jeni të sigurt që do ta shfrytëzojë hapësirën ligjore, por nëse do t'i detyroni dhe t'u fusni idenë që po bëjmë reformë dhe një lloj dhune administrative që ti do të dalësh më vete, të jeni të sigurt që një pjesë të popullsisë do ta lini pa shërbime dhe do t'jua bënë gati këtë moseficiencë të shërbimit publik peshkaqenëve privatë që janë gati duke pritur. Kjo periudhë 30-vjeçare ka treguar që shërbimi publik është rrudhur dhe shërbimi privat është zgjeruar. Pse? Kjo për efekt të eficiencës, të kapacitetit dhe të agresivitetit që është.

Unë do të isha dakord për ligjin, por a është i zbatueshëm për Shqipërinë? Gjykoj që ligjin së bashku me disa reforma të tjera t'i shtyjme nëse duam t'u japim autonomi. Kështu kemi folur edhe para disa vitesh për autoniminë universitare, po ku është? Në fakt, universitetet kishin një *fee* të detyrueshme për provimet e për tjera, pra ishte më i matshëm mekanizmi dhe kur vjen puna ku është autonomia universitare?

Për mua do të ishte mirë që të fillonim me të parën, atje ku është e mundur, ndoshta edhe për disa shërbime duke i lokalizuar në mënyrë që qytetari ta pranojë *fee*-në edhe për spitalet publike. Një pjesë e shqiptarëve do ta pranonin vizitën e doktorit, sepse është ai koncepti i “profesorit”, dreqit apo shejtanit, por nëse do t’u ngarkojmë që për çdo lloj shërbimi të paguajnë para, atëherë ky shërbim nuk do të jetë më publik.

(Diskutime pa mikrofon)

Këto ishin ato që kisha.

Eduard Shalsi – Nuk kishte asnjë gjë me ty.

Alban Xhelili – E kisha më shumë për fjalën “revolucion”. Revolucioni nënkupton sikur do të vriten njerëz...

Eduard Shalsi – Jo.

Alban Xhelili – Revolucioni është një ndryshim radikal. Këtu jemi duke folur për një ligj, i cili...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju ma përmendët fjalën revolucion...

Dashamir Shehi – Unë e thashë si batutë.

Alban Xhelili - Unë e përmenda edhe atë pjesën, kështu që ajo nuk kishte kuptim.

(Diskutime pa mikrofon)

Në atë prizëm e kisha edhe unë.

Eduard Shalsi – Ishte një batutë për të kuptuar që pritshmëria është e madhe nëse bëhej fjalë për revolucion dhe nëse bëhej fjalë për evolucion...

(Diskutime pa mikrofon)

Zonja Koliqi, fjala për ju.

Më pas fjalën e ka zoti Sinaj.

Emilja Koliqi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në lidhje me këtë projektligj, sipas materialit të raportit të vlerësimit të ndikimit, aktualisht sistemi spitalor është i përbërë nga 5 spitale universitare, 24 bashkiakë, 11 rajonalë dhe 2 spitale psikiatrike. Në kategorizimin e ri që bëhet sipas projektligjit thuhet që spitalet ditore do të jenë në nivel bashkie, qarku, rajonal, terciar dhe spitali Qendra Spitalore Universitare. Si do të përputhet ndarja që është sot me ndarjen e re, pra si do të bëhet kombinimi?

Unë jam përfaqësuese e Shkodrës, e cila ka një spital rajonal që mbulon një popullsi mesatare të regjistruar, në gjendjen civile është më shumë, me rreth 200 mijë veta, që janë banorët sot.

Dua t'ju bëj një pyetje në lidhje me investimet. Nëse do të ketë autonomi financiare, kjo autonomi financiare dhe të ardhurat që do të mblidhen ose do të vijnë nga burime të ndryshme, sa për qind e tyre do të përdoren për investime nga vetë spitalet?

Në Shkodër ka një shqetësim që lidhet me një skaner që ndodhet në spitalin rajonal, i cili është i vjetër dhe i takon vitit 2011. Për të bërë një skaner njerëzit duhet të regjistrohen 2 muaj përpara, por radha nuk vjen kurrë, sidomos kjo është më shumë sa u takon rasteve urgjente. Pra, një spital rajonal shumë i rëndësishëm, që mbulon një popullsi prej 200 mijë e më shumë banorë, ka një skaner të vitit 2011.

Duke pasur si bazë autonominë financiare, sa do të jenë në gjendje këto spitale të kryejnë investimet, ndërkohë që kërkesat janë të vazhdueshme? Një pyetje tjetër: sa do të ndikojë ky projektligj në mosikjen e personelit mjekësor, mjekë dhe infermierë, pasi kohët e fundit kemi një emigrim shumë të madh të tyre? Sa do të ndikojë kjo autonomi në këtë drejtim?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Koliqi!

Fjalën e ka zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre!

Nga ajo që u dëgjua gjatë prezantimit të projektligjit dhe nga ato që kemi lexuar duket qartë që Ministria e Shëndetësisë ka bërë një analizë, duke i përshtatur realitetit që kemi në vend si sa i takon shpërndarjes së popullsisë, ashtu edhe numrit të mjekëve. Për të mos pasur spitale për spitale apo shërbime mjekësore për shërbime mjekësore kuptohet qartë që sistemi i ri, që do të ndërtohet, do të jetë një sistem që do ta rrisë kujdesin ndaj qytetarit dhe do ta përmirësojë shërbimin shëndetësor, duke profilizuar spitalet dhe shërbimi shëndetësor do të jetë falas.

Sa i takon alternativës së autonomisë kjo është diçka tjetër, pra është një plus që u ofrohet qytetarëve, të cilët do të kenë nevojë për një shërbim më të shpejtë apo më të kualifikuar, pra nuk shoh që do të humbasë shërbimi shëndetësor falas.

Kam disa pyetje. Mjekët që do të punojnë jashtë orarit, duke ofruar shërbimet e tyre për vizita besoj se do të kenë pagesa më vete. Dua të di si do të jenë pagesat e tyre? Po me qendrat

shëndetësore që janë sot në zonat rurale dhe me ambulancat e fshatrave çfarë do të ndodhë me ta, a do të vazhdojnë?

Zonja Ministre, sa kohë do të duhet të zbatohet ky ligj dhe të ndërtohet sistemi i ri shëndetësor në Shqipëri?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Këtu përmbillet pjesa e pyetjeve dhe e diskutimeve.

Fjalën e ka ministrja para se të kalojmë në votim.

Ju lutem, përgjigjuni pyetjeve, si dhe, nëse keni komente për sugjerimet dhe vërejtjet konstruktive që u bënë në komision!

Ogerta Manasterliu – Falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit për të gjitha komentet dhe sugjerimet e tyre, por edhe për vendosjen e vëmendjes tek elementet shumë të rëndësishme të këtij projektligji!

Sinqerisht ju falënderoj, pasi është një mundësi më shumë për ne për t'u shpjeguar si hartues dhe propozues të kësaj nisme, por, gjithashtu, edhe për t'i sqaruar qytetarët!

Ajo çka unë besoj se është e rëndësishme, këtu u referohem sugjerimeve dhe komenteve të zotit Shehi, është që autonomia spitalore si një model i ri i autonomisë do të jetë e përshkallëzuar, pikërisht, sepse edhe ne kemi vlerësuar faktin që ndryshimet radikale në sistem duhet të jenë mirëmenduara, të mirëprojektuara, por mbi të gjitha të kenë qëndrueshmëri, pra të mos bëjnë hapa prapa, ndërkohë që ne duam ta zhvillojmë sistemin.

Autonomia spitalore ka dy faza, autonominë menaxheriale, këtu i referohem pikërisht modelit të parë, që është dhënia e autonomisë administrative, organizative dhe rregullatore, të spitaleve publike bazuar mbi përcaktimet e kartës së autonomisë spitalore vendore dhe ky model i autonomisë menaxheriale do të aplikohet së pari te spitalet duke parë dhe vlerësuar edhe mënyrën si ato do të menaxhojnë këtë autonomi, do të kalohet në fazën e dytë që është autonomia financiare, që garanton më pas transformimin e spitaleve publike në institucione që financohen nga buxheti i shtetit ose vetëfinancohen nga burime të ligjshme të bazuara në kartën e autonomisë. Pra, në këtë pikë besoj se reflektojmë shqetësimet e njëri-tjetrit në raport më autonominë dhe fazat e zbatimit të autonomisë spitalore. E përsëris edhe një herë edhe vende si Spanja, Portugalia, pa dashur t'iu referohem, sepse nuk po bëj referencë të zhvillimit të sistemeve të tyre, por përfshirjet t modeleve të reja brenda sistemeve duan kohën e tyre për t'u aplikuar ose zbatuar. Ndaj ky ligj që ne sjellim sot është shumë ambicioz dhe mbart shumë sfida

në vete, ku i pari është ndryshimi i mendësisë për të rritur transparencën dhe llogaridhënien për sa i përket efektivitetit të shërbimeve dhe zbatimit të instrumenteve që ky ligj ndërton.

Ky ligj do të shkojë paralel me një paketë aktesh që do të duhet të ndryshohen dhe që i përkasin reformës në ligjin për sigurimet shëndetësore të detyrueshme. Është Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor që financon spitalet, por ajo që ne kemi vlerësuar edhe gjatë hartimit të këtij ligji dhe e kemi përshkruar, gjithashtu, në relacionin përkatës është që, paralelisht me zbatimin e tij dhe me përgatitjen e sistemit, ndryshimet e tjera ligjore do të jenë pikërisht te ky ligj. Për të reflektuar ato nevoja që sistemi ynë shëndetësor, spitalor dhe parësor, t'i përgjigjet nevojave të qytetarëve tanë. Me të drejtë u ngrit këtu shqetësimi në aspektin e kujdesit që ne duhet të tregojmë, në fakt, për shërbimin ndaj qytetarëve dhe që lidhet me spitalet jopublike. E vërteta është se ky ligj e sheh si komplementar spitalet jopublike, por nga ana tjetër ruan parimet e solidaritetit universalitetit dhe mos diskriminimit që do të thotë që qytetarët shqiptarë në spitalet publike do të kenë të gjithë aksesin dhe garancinë e shërbimeve të përballueshme cilësore dhe të aksesueshme. Por nga ana tjetër ashtu siç kemi bërë edhe sot që flasim paketat e shërbimeve spitalore, të cilat janë të kostifikuara sot nga ne sikurse është paketa e transplantit, sikurse është paketa e dializës, sikurse është paketa e kardiokirurgjisë janë shërbime që sot financohen nga shteti edhe në spitalet jopublike. Autonomia spitalore e krijon këtë premisë, që për shërbime të caktuara ku shtetit i duhet një investim më i madh në kohë, por që privati mund ta ketë ezauruar këtë si investim të mundet të krijojë paketa sipas kostove të shërbimit dhe të orientuara nga tregu për të blerë edhe shërbime tek të tretët, sigurisht sipas dispozitave ligjore në fuqi. Shërbimet për qytetarët i jap rëndësi kësaj në aspektin e numrit të shtretërve ne në vendin tonë spitalet publike dhe jopublike kanë rreth 9 mijë shtretër spitalorë dhe prej tyre janë më pak se 10% në spitalet jopublike. Kjo do të thotë se volumi i madh i shërbimeve spitalore kryhet në sistemin publik. Në këtë aspekt ne duhet ta fuqizojmë atë duke garantuar më shumë ndërhyrje të specializuara në strukturat tona jopublike në mënyrë që qytetarët të ulin shpenzimet nga xhepi sikurse kanë ardhur duke u reduktuar këto vite.

Nga ana tjetër ka një rëndësi shumë të madhe mënyrë e shpenzimit të të ardhurave dytësore, ajo që zonja Koliqi tha. Ne në këtë ligj e kemi përcaktuar që të ardhurat dytësore të spitaleve do të përdoren për mallra dhe shërbime sipas nevojës dhe zhvillimit të infrastrukturës, teknologjisë dhe burimeve njerëzore. Dhe kemi dashur ta përfshijmë në ligj pikërisht për t'i dhënë garancinë që destinacioni i të ardhurave dytësore do të jetë në këto drejtime, kryesisht në

drejtim të teknologjisë dhe mbështetjes së burimeve njerëzore, qoftë sa i përket edukimit në vazhdim për mjekët dhe infermierët, qoftë edhe sa i përket pagesave për performancë që do të vijnë për shërbimin ekstra ditor dhe normave ditore të punës të përcaktuara në spitale. Kjo është garancia që mjekët do të qëndrojnë brenda spitaleve publike, sepse aty do të gjejnë garancinë që do të jenë incentivuar financiarisht. Sigurisht që kjo kërkon shumë punë, dhe metodologji dhe instrumente kontrolli shumë të detajuar në mënyrë që shërbimi që ofrohet gjatë orarit të punës dhe normat e shërbimit të jenë të plotësuara dhe të jenë të balancuara në çdo shërbim. Pra, ashtu siç e tha kolegu nëse një qytetar do ta marrë shërbimin tek një mjek që është profesor dhe jo te mjeku i turnit atëherë patjetër që mund të vlerësohet që nëpërmjet korsisë preferenciale ose nga një qytet tjetri kur sistemi i referimit të thotë, që duhet ta marrësh këtu këtë shërbim, sepse unë po ta ofroj këtë shërbim, atëherë do të duhet të kemi të përcaktuara edhe instrumentet në raport me korsinë preferenciale që ky ligj e organizon. Kjo është një garanci që personeli do të qëndrojë brenda spitaleve publike madje edhe përtej orarit të punës, sepse një mjek që bën një punë jashtë orarit duhet të shkojë ta shohë pacientin, sepse është aty. Pra, ne përfitojmë dyfish.

Sa i përket pyetjes se çfarë do të ndodhë me sistemin parësor, ambulancave, ne sistemin parësor nuk e shohim të ndarë nga sistemi spitalor, sepse, nëse jemi duke bërë një ligj që ne organizojmë më mirë një sistem spitalor. Sistemi parësor është filtri ku ne garantojmë shëndetin për popullatën. Nëse do të ishim thjesht të orientuar vetëm të sistemi spitalor atëherë do të mëremi me sëmundjen, por, ndërkohë, ne merremi më politikat e ruajtjes së shëndetit. Të gjitha instrumentet që ne kemi ndërtuar për sistemin parësor lidhur me programet e parandalimit, check-up-in me programet e parandalimit të kancerit të qafës së mitrës, kancerit të gjirit të vaksinimit janë programe në mbrojtje të shëndetit në uljen e barrës së sëmundshmërisë dhe sëmundjeve që e shkaktojnë ato.

Nga ana tjetër ne do të vijojmë që qendrat shëndetësore t'i kemi në prioritet tona sa i përket rehabilitimit dhe krijimit të kushteve të infrastrukturës. Gjithashtu jemi duke përgatitur me ekspertë e ministrisë dhe OBSH-së një plan për kategorizimin e qendrave shëndetësore duke mundësuar kështu edhe një paketë të adaptuar me kujdesin që sot kërkohet, për strukturat 24-orëshe të qendrave shëndetësore me mjekë dhe infermierë. Pra të gjitha këto janë pjesë e reformës.

Sa kohë do që të implementohet? Sfida është për ta implementuar sipas afateve që ne duam. 9 muaj kohë kemi kërkuar nga ky ligj për të ndërtuar të gjithë bazën e akteve nënligjore

udhëzimeve VKM-vë. Ajo që është e rëndësishme është që ne paralelisht do të punojmë për të gjitha aktet dispozitat e këtij ligji. Ne do të fillojmë implementimin e autonomisë spitalore në spitalin memorial të Fierit menjëherë, sepse një dispozitë kalimtare e këtij ligji është aplikimi i autonomisë menaxheriale në këtë spital, duke krijuar kështu bazën e të gjithë dokumentacionit që do të na duhet për të aplikuar në spitalet e tjera. Sigurisht autonomia spitalore është një model i cili do të jetë një proces dhe që do të fillojmë me ndërtimin e të gjithë instrumenteve të parashikuara në këtë ligj.

Faleminderit!

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ndjesë së mbase kalova këtë pyetje pa përgjigje. Sa i përket kategorizimit të spitaleve është plani kombëtar spitalor, i cili do të kategorizojë spitalet në nivel kombëtar dhe nivel rajoni spitalet sipas disa kriterëve, të cilat janë ato demografike, sëmundshmëria, aspekte që lidhen me nivelet sociale dhe ekonomike të zonave të cilat do të zhvillohet plani rajonal dhe sigurisht ai kombëtar që parashikon të gjitha modalitetet.

Sa i përket strukturimit të spitalit këtu flas për spitalin e Shkodrës, spitali i Shkodrës është një ndër spitalet për të cilin ne krenohemi për investimet që kemi bërë dhe për të thënë të vërtetën. Sapo mora informacion që një skaner në spitalin e Shkodrës nuk e kalon 48-orëshin për t'u realizuar dhe nuk konsiderohet listëpritjeje një skaner, i cili kryhet deri në 48 orë, por edhe 72 orë. Listat e pritjes për të kryer skanerët e planifikuar jo ato të urgjencës, sepse për atë skaneri bëhet direkt. Sa i përket ekzaminimit ne kemi një sistem *e-ekzaminime*, pra sistem elektronik, por për skanerët nuk kemi listëpritjeje, kryesisht në të gjitha spitalet.

Edhe në QSUT, që është spitali, që ka volumin më të madh, që mbulon Tiranën, nuk kemi listë pritjeje për skanerin. Nëse e kemi fjalën për rezonancën që është sërish një ekzaminim terciar, i cili është në sistemin e referimit për ekzaminim të planifikuar, me sa u informova, shkon 18-20 ditë që është brenda të gjithë parametrave dhe madje mund të krahasohemi edhe me vende të tjera. Shërbimet e ekzaminimeve terciare të planifikuara duhet të bëhen në mënyrë transparente dhe që secili të ndjekë radhën. Sa i përket urgjencës nuk ka listë pritjeje.

Sa i përket rinovimit të pajisjeve, Shkodra është një ndër spitalet më të kompletuara që ka edhe një shërbim të hemodinamikës, pra ka edhe audiografin, ka edhe rezonancën, ka edhe skanerin. Sot po flasim për rinovim, po i shikojmë disa ndryshime, sepse dje flisnim për funksionim, sot flasim për funksionim që t'i kemi jo të 2011-tës, por të 2021-shit. Pra jemi duke

punuar dhe ky ligj është një garanci më shumë se investimet në spitale do të vazhdojnë dhe spitalet të kenë mundësi edhe të investojnë, për aparatura të mëdha të teknologjisë së lartë strategjia e investimeve është e qeverisë dhe e ministrisë, por për të gjitha investimet, që i përkasin kardiologjisë bazë, patjetër që të ardhurat do të mundësojnë përmirësimin e flotës së pajisjeve biomjekësore.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit kolegëve për debatin!

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” .

Kush është pro në parim? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 6. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 7. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 8. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 9. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 10. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 11. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 12. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 13. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 14. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 15. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 16. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 17. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 18. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 19. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 20. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 21. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 22. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 23. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 24. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 25. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 26. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 27. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 28. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 29. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 30. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 31. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 32.

Antoneta Dhima- Te neni 32, pika 2, mos është bërë ndonjë lapsus se neni 17 pika 3 nuk ka germë “c”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Atëherë, me propozimin e sugjeruar nga zonja Dhima, kush është dakord me nenin 32? Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 33. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 34. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Atëherë, duke përbyllur ditën e sotme falënderoj përfaqësuesit e ministrisë dhe deputetët për debatin!

Ju njoftoj se nesër, me kërkesë të një numri deputetësh, mbledhja e ditës së mërkurë nuk do të zhvillohet për shkak të disa aktiviteteve që një pjesë e deputetëve kanë. Nesër do të bëhet mbledhja për shoqatën e mikrofinancës. Ndërkohë jemi njoftuar që janë shpallur kandidaturat, por sipas shërbimeve të Kuvendit letra zyrtare është ende në mbërritje e sipër, çka do të thotë se nuk bëjmë dot dëgjesat me kandidatët për anëtarë të Autoritetit të Konkurrencës ku siç dihet janë 4, që do të thotë do ta spostojmë për javë tjetër.

Rishihemi nesër në orën 12:00. Të mërkurën nuk kemi aktivitet.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare e Komisionit
Enslemvera Zake

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar administrativ
Elvi Prifti